



AGJENCIA E KËRKIMIT
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT


GUIDË

**KËRKIM EFICIENT PËR PROJEKTET
EUROPIANE TË KËRKIMIT**




GUIDË

**KËRKIM EFICIENT
PËR PROJEKTET EUROPIANE
TË KËRKIMIT**



PËRMBAJTJA

1.	Kërkimi i thjeshtë në GOOGLE	7
2.	Platforma Google për ruajtjen e punimeve të kërkimit shkencor	11
3.	Platforma dhe motorë të tjerë kërkimi	13
4.	Ku të kërkohet për Programet e Kërkimit të Bashkimit European	15
5.	European Commission Research & Innovation	19
6.	CORDIS	27
7.	FP7 - Seventh Framework Programme for Research and Technological Development - Programi Kuadër Shtatë për Zhvillimin e Kërkimit dhe Teknologjisë	37
8.	Marie Curie Actions - Aksionet Marie Curie	67
9.	COST - European Cooperation in Science and Technology - Bashkëpunimi European për Shkencën dhe Teknologjinë	73
10.	EUREKA Projects - Projekti EUREKA	77



“DY FJALË KOLEGËVE NË VEND TË HYRJES”

Të nderuar studiues, pedagogë dhe pjesëtarë të komunitetit shkencor. Si koleg dhe pjesëtar i këtij komuniteti për më tepër se tre dekada, kam dëshirën dhe kënaqësinë t’ju drejtohem me dy fjalë.

Siç e dini, sot Interneti është një nga mjetet më të rëndësishme për informimin e publikut me informacionet më të reja. Në të gjendet një gamë e madhe informacioni dhe ne shpesh ndodhemi në vështirësi për selektimin e tij.

Në këtë kuadër Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, është përpjekur të përmbledhë në një punim të vetëm koncepte bazë të përdorimit të internetit me qëllim informimin mbi Programet dhe Rrjetet Kërkimore Shkencore.

Botimi i kësaj « Guide » ju drejtohet juve si Komunitet Kërkimor - Shkencor, pedagogë dhe studiues, përfshirë këtu Kërkues Individual, Grupe Kërkimore -Shkencore, Universitete Publike dhe Private, Institute dhe Institucione Kërkimore Shkencore, me veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

Kjo « Guide » ka për qëllim t’ju ndihmojë sadopak në gjetjen e informacionit të nevojshëm për Programet dhe Rrjetet Kërkimore Shkencore të Komunitetit European.


Fillimisht janë dhënë disa rregulla të cilat duhen pasur parasysh për kërkim sa më të thjeshtë të informacionit që nevojitet. Në vazhdim do të gjeni një përmbledhje të portaleve web më të rëndësishme për Kërkimin Shkencor në Europë.

Në këtë libërth do të gjeni gjithashtu informacion të detajuar mbi disa nga institucionet kërkimore shkencore Europiane dhe mënyrën e navigimit në faqet e tyre zyrtare.

Duke shpresuar që në këtë material t’ju bëhemi sadopak të vlefshëm, ju uroj suksese të mëtejshme në punën tuaj kërkimore shkencore.

Me Respekt,
Prof. Dr. YLLI PANGO

Drejtor i Përgjithshëm
Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit



I

Kërkimi i thjeshtë në GOOGLE

Sot Interneti është një nga mjetet më të rëndësishme për informimin e publikut me informacionet më të reja. Në të gjendet një gamë e madhe informacioni dhe ne shpesh ndodhemi në vështirësi për selektimin e tij. Më poshtë, do të gjeni disa metoda që duhet të keni parasysh për një kërkim sa më të thjeshtë dhe të suksesshëm. Për të kërkuar sa më thjeshtë në [Google](#) duhet të kemi parasysh këto gjëra:

Fraza eksplicite

Përdorni një frazë sa më eksplicite për atë që jeni duke kërkuar. Për shembull, supozojmë që ju jeni duke kërkuar për projektet e kërkimit të Bashkimit Europian. Në vend që të shkruani në fushën e kërkimit të “Google” - “EU research programme”, vendoseni shprehjen midis kllapave.

Shembull kërkimi: “EU research programme”

Përrjashtoni fjalët

Supozojmë që jemi duke kërkuar për projektet e kërkimit të Bashkimit Europian, por ju dëshironi të shfaqni ato rezultate që përmbajnë fjalën “guidelines”. Për të bërë këtë gjë thjesht përdorni shenjën “-” para fjalës që do të ekzekutoni.

Shembull kërkimi: EU research programme - guidelines

Kërkimi për një faqe të caktuar

Shpesh, ju doni të kërkonit një faqe të veçantë përmbajtja e së cilës përputhet me një frazë të caktuar. Edhe në qoftë se faqja nuk ka një motorë kërkimi të saj, ju mund të përdorni kërkuesin e Google-it për të kërkuar këtë faqe interneti për termin tuaj. Thjesht përdorni modifikuesin “site: emersite.com”.

Shembull kërkimi: “EU research programme” site:ec.europa.eu

Fjalë të njëjta dhe sinonime

Le të supozojmë se ju doni të përfshini një fjalë në kërkimin tuaj, por gjithashtu ju dëshironi të përfshini në kërkim dhe sinonimet e kësaj fjale. Për të realizuar këtë gjë përdorni “~” përpara fjalës.

Shembull kërkimi: “EU research programme” ~health



Tip të caktuar dokumenti

Nëse ju dëshironi që rezultati i kërkimit të jetë në një format të caktuar, ju mund të përdorni modifier “filetype:”. Për shembull, ju jeni duke kërkuar një prezantim në PowerPoint lidhur me programet e kërkimit të Bashkimit Europian në internet ju duhet të shkruani:

Shembull kërkimi: “EU research programme 2011 filetype:ppt”

Këtë apo atë

Kur ju jeni duke kërkuar diçka, “Google” automatikisht do të përfshijë të gjithë termat e specifikuar në kërkim. Nëse ju jeni duke kërkuar për një, ose më shumë terma që lidhen midis tyre, atëherë ju mund të përdorni operatorin OR (Shënim operatori OR duhet të jetë me shkronja kapitale).

Shembull kërkimi: “EU research programme OR EU research fund”

Kodi telefonik i një zone

Nëse duhet të dini se kujt zone, ose qyteti i përket një kod telefonik. Ajo që duhet të bëni është të shkruani kodin në fushën e kërkimit dhe “Google” do t’ju thotë se i kujt zone është.

Periudhat kohore

Kjo gjë është shumë pak e përdorshme, por është dhe një procedurë shumë e vlefshme. Le të supozojmë se ju doni të dini rezultatet që përmbajnë një varg numrash. Ju mund ta përftoni këtë duke përdorur modifier X..Y , çfarë ka ndodhur midis dy periudhave X dhe Y. Ky tip kërkimi është i përdorshëm për vitet, çmimet ose kur ju dëshironi të merrni një seri numrash si përgjigje.

Shembull kërkimi: EU research fund 2000..2011

Përkufizimet e fjalës apo frazës


Nëse keni nevojë të shpejt të shikoni përkufizimin e një fjalë apo fraza, thjesht përdorini komandën “define”.

Shembull kërkimi: define:programme

Llogaritjet

Nëse ju duhet të bëni llogaritje të shpejta, në vend që të hapni aplikacionin e makinës llogaritëse, ju mundet të shkruani menjëherë formulën në “Google” dhe do të merrni vlerën.

Shembull kërkimi: 48512 * 1,02



Konvertimi i njësive

“Google” ju mundëson konvertimin në të gjitha njësitë që ekzistojnë. Ju thjesht shkruani në fushën e kërkimit konvertimin që ju dëshironi dhe “Google” do ju japi përgjigjen.


Shembull kërkimi: 150cm in inch

Moti dhe Ora

“Google” ju jep informacion në kohë reale për orën dhe motin për çdo qytet ose shtet të botës. Thjesht përdorni “Weather, emri i qytetit dhe time, emri qytetit.

Shembull kërkimi: weather Tirana

Shembull kërkimi: time Tirana



2

Platforma “Google” për ruajtjen e punimeve të kërkimit shkencor

“Google” ofron një platformë më vete si “Google Scholar” ku ruhen të gjithë punimet shkencore në fusha të ndryshme si dhe një platformë për libra si më poshtë:

Google Scholar

<http://scholar.google.com/> është një platformë ku mund të gjeni abstrakte dhe punime nga gazeta dhe revista shkencore dhe akademike. Kjo pjesë e platformës mundëson një formë kërkim të thjeshtë ku mund të kërkoni nëpërmjet fjalëve kyç. Gjithashtu ofron dhe kërkimin e avancuar ku mund të kërkohet një punim duke u bazuar në fushën e punimit, emrin e autorit, titullin e punimit, një frazë që mund të jetë në punim, etj.

Kërkimi për Libra


<http://books.google.com/> është një platformë ku mund të gjeni libra të ndryshëm. “Google” ka skanuar dhe indeksuar çdo libër që ndodhet në shumicën e librarive në internet. Ju mund të gjeni librin që dëshironi thjeshtë duke kërkuar në fushën e kërkimit një frazë që mund të përmbajë libri, emrin e autorit, titullin e librit, etj. Ju mund të lexoni librin e plotë, nëse ai është pa pagesë, ose ju tregohet mënyra që duhet të ndiqni për ta blerë atë.

Faqja e kërkimit të avancuar

Ju mund të përdorni faqen e kërkimit të avancuar të “Google” http://www.google.ca/advanced_search për të kërkuar në mënyrë të avancuar. Kjo faqe ofron një metodë kërkimi më specifike, duke u bazuar në kritere që i vendosni ju.

Referencat

Si në “Google Scholar” ashtu dhe në “Google” ju do të gjeni një liste të punimeve që lidhen me një temë të caktuar ashtu dhe me punimet që priten të realizohen në të ardhmen. Pra gjithmonë do të gjeni referenca që do ju ndihmojnë në kërkimin tuaj. Kjo do t’ju ndihmojë shumë në mbledhjen e sa më shumë informacioneve.



Përkthimi

Nëse dëshironi të lexoni një punim i cili është në një gjuhë që ju nuk e njihni, përdorni mjetin “Language Tool” në të djathtë të faqes kryesore të “Google”, ose <http://translate.google.com/> për ta përkthyer në një nga gjuhët që ju njihni. Ju sugjerojmë që nëse keni një dokument që është në një gjuhë që ju nuk e njihni, përkthejeni në anglisht, por asnjëherë në shqip se nuk do të arrini të kuptoni asgjë, duke qenë se përkthimi në shqip nga “Google” është i një niveli shumë të ulët.

3

Platforma dhe motorë të tjerë kërkimi

Ekzistojnë platforma të ndryshme në internet që shërbejnë si baza të dhënash për ruajtjen e punimeve dhe informacioneve. Më poshtë janë të listuara disa nga to:


SIRIUS - <http://www.scirus.com/> - është motori i kërkimit më eficient për kërkimin e punimeve shkencore, në fusha të ndryshme. Ai është i pajisur me teknologjinë më të avancuar të kërkimit. “Sirius” kërkon në mbi 200 milion faqe web-i, të dedikuara projekteve shkencore dhe ju mundëson kërkim të shpejt dhe të lehtë për:

- ◆ Të dhëna mbi projektet shkencore, të dhëna teknike, mjekësore dhe artikuj shkollorë;
- ◆ Raporte, artikuj, punime, gazeta dhe revista shkencore;
- ◆ Ofron një funksionalitet të veçantë për kërkuesit dhe shkencëtarët.

Kjo platformë, gjithashtu, ofron një formë kërkimi të avancuar mbi bazën e disa kritereve shumë efikase si: kërkimi nga bashkimi i dy frazave me anë të tre mënyrave (and – dhe, or – ose, and not – dhe jo), datën e publikimit, tipin e informacionit, formatin e skedarit, burimi i informacionit dhe fusha e kërkimit. Kjo formë e avancuar ju lehtëson shumë në gjetjen e punimeve që lidhen më shumë me atë çka ju po kërkoni.

DMOZ – Open Directory Project – <http://www.dmoz.org/> - është një nga direktorit më të mëdha e cila është ndërtuar dhe mirëmbahet nga një komunitet global i përbërë nga editorë vullnetarë. Projektet shkencore, ose materialet që lidhen me to ju mund t’i gjeni tek: <http://www.dmoz.org/Science/>

WIKIPEDIA – <http://www.wikipedia.org/> - është një enciklopedi pa pagesë, e krijuar nga njerëz nga e gjithë bota në gjuhën e tyre amtare. Këtu ju mund të gjeni detaje dhe shpjegime pothuajse për çdo subjekt që ju interesoheni. Gjithashtu ju në mënyrë vullnetare mund të ngarkoni dokumente për të cilët ju jeni ekspert.



Në linket e mëposhtme do të gjeni një përmbledhje të të tërë motorëve të kërkimit që ekzistojnë sot në internet, të ndarë sipas fushave:

<http://oedb.org/library/college-basics/research-beyond-google>

<http://www.thesearchenginelist.com/>

4

Ku të kërkojmë për Programet e Kërkimit të Bashkimit Europian?

Më poshtë janë listuar faqet web, më të rëndësishme, ku ju mund të referoheni për t'u informuar mbi projektet dhe programet në shkencë, teknologji dhe inovacion.

EU Commission - Komisioni Europian, trupi ekzekutiv i Bashkimit Europian është një nga tre institucionet kryesore të Bashkimit Europian. Roli kryesor i Komisionit Europian është të propozojë dhe implementojë legjislacione dhe të mbikëqyrë traktate të BE-së, të cilat formojnë bazën ligjore të BE-së. http://ec.europa.eu/index_en.htm është portali i Komisionit Europian, aty mund të gjeni çdo informacion mbi fondet dhe projektet e tij. Linke të tjera të këtij siti që do t'ju ndihmojnë, janë dhënë më poshtë.


EC Research & Innovation - <http://ec.europa.eu/research/index.cfm> Kjo platformë është projektuar për të publikuar të gjithë informacionet mbi kërkimin në Europë. Çdo kërkues, në të gjitha fushat e kërkimit, do të gjejë në këtë faqe gjithçka mbi të rejat e politikave, vendimeve dhe projekteve të kërkimit në Europë. Nëpërmjet menysë: **"Who are you?"**- në të majtë, në fund të faqes, do të gjeni informacion të ndarë, sipas fushës, apo profesionit që ju keni.

Gjithashtu ju mund të përdorni dhe fushën **"Search"** për të kërkuar në faqe, duke përdorur **Index**, ose **Site Map** (hartat e faqes).

Në linkun <http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/home> do të gjeni informacione mbi pjesëmarrësit në projekte.

Në linkun <http://ec.europa.eu/research/index.cfm?lg=en&pg=who&cat=a&tips=on> do të gjeni informacion, të ndarë sipas fushave të kërkimit.

Në linkun <http://ec.europa.eu/research/rea/> do të gjeni informacion mbi REA – "Research Executive Agency", që është agjencia që merret me menaxhimin e fondeve. Nëse vizitoni këto faqe do të merrni dhe informacione të tjera të dobishme.



CORDIS - The Community Research and Development Information Service - është faqja zyrtare e internetit për të gjitha Programet Europiane të Kërkimit dhe Zhvillimit.

http://cordis.europa.eu/home_en.html është linku i projekteve të kërkimit të BE. Në të mund të gjeni informacione në lidhje me programet, mënyrën e aplikimit dhe kriteret e aplikimit.

FP7 - 7th Framework Programme of Research and Technological Development of the European Commission - Programi i 7 Kuadër i Zhvillimit Shkencor dhe Teknologjik i Komisionit Europian.

Ky program ndahet në Programe Specifike :

- ◆ Cooperation (Bashkëpunimi)
- ◆ Ideas (Idetë)
- ◆ Capacities (Kapacitetet)
- ◆ People (Njerëzit)
- ◆ Euroatom (Euroatomi)
- ◆ JRC- Joint Research Centres (Qendra të përbashkëta Kërkimi)

Linku i këtij Programi është : http://cordis.europa.eu/fp7/home_en.html

CIP - Competitiveness and Innovation Framework Programme - Programi i Konkurrencës dhe Inovacionit. Ky program synon të mbështesë aktivitetet inovative dhe të sigurojë një akses më të mirë për financimin dhe shpërndarjen e shërbimeve mbështetëse të biznesit në rajone. Target grupet e këtij Programi janë SME-të (Ndërmarrjet e Vogla e të Mesme). CIP vepron nga 2007-2013 me një buxhet prej € 3621 milion Eurosh dhe është i ndarë në tri programe operacionale: EIP, ICT-PSP, IEE. Faqja web ku mund të gjeni më shumë informacion: http://ec.europa.eu/cip/index_en.htm

COSME - Programme for the Competitiveness of enterprises and SMEs 2014-2020 - http://ec.europa.eu/cip/cosme/index_en.htm - është një program i ri për SME-të (Ndërmarrjet e Vogla e të Mesme) që do të veproj në periudhën 2014 - 2020 me një total buxheti prej 2.5 bilion Euro dhe do të fokusohet në:

- ◆ Lehtësimin e aksesit në financat e SME-ve (Ndërmarrjet e Vogla e të Mesme);
- ◆ Krijimin e një ambienti të favorshëm për krijimin dhe rritjen e biznesit;
- ◆ Krijimin e një kulture sipërmarrëse në Europë;
- ◆ Suportimin e ndërkombëtarizimit të SME-ve (Ndërmarrjet e Vogla e të Mesme); dhe përmirësimin e qasjes së tyre në treg.



Practical guide for EU Funding - http://cordis.europa.eu/eu-funding-guide/home_en.html - këtu do të gjeni një guidë praktike mbi fondet e Komisionit European.

Projects Science, Technology and Innovation - <http://www.projects.eu.com/> - “Project” është një web -site dhe revistë, dedikuar çdo personi, që është pjesë e kërkimit në shkencë, teknologji dhe inovacion në Europë.

Faqja web ofron për çdo kërkues njoftime, informacione për projektet shkencore dhe opinione nga ekspertë R&D, më të mire.

Revista “Project” është një nga revistat më të rëndësishme të shkencës, teknologjisë dhe inovacionit në Europë që përmban informacionet e fundit mbi projektet e kërkimit, investimet dhe rregullat që drejtojnë dhe çojnë përpara kërkimin dhe inovacionin në Europë. Për më shumë informacion vizitoni linkun.


European Research Area (ERA) - http://ec.europa.eu/research/era/index_en.htm - Zona Europiane e Kërkimit përbëhet nga të gjitha aktivitetet e zhvillimit dhe kërkimit, programet dhe politikat në Europë, të cilat përfshijnë një perspektivë transnacionale. Së bashku, ato mundësojnë kërkuesit, institucionet kërkimore dhe bizneset të qarkullojnë, konkurrojnë dhe bashkëpunojnë, përtej kufijve.

Europa Media Training - <http://www.eutrainingsite.com/> - ofron informacion mbi fondet e programeve të EU, FP7 dhe LLP, kohëzgjatjen e tyre, mënyrën për t'u bërë pjesë e programeve dhe si t'i menaxhojmë në mënyrë eficientë.

Në linkun <http://www.eutrainingsite.com/publications.php> do të gjeni publikimet që ofrohen nga ky organizëm dhe që do t'ju ndihmojnë në kërkimin dhe aplikimin, në projektet e Bashkimit European.

Në linkun e mëposhtëm do të gjeni diagramën e ndarjes së fondeve: http://www.eutrainingsite.com/eu_funds.php?gclid=CNzwkr2e3qwCFQQm3godGHNHZQ

Welcomeurope - <http://www.welcomeurope.com/> - është një faqe tjetër që informon mbi grandet e Europës. Në të do të gjeni informacione, monitorime, trajnime dhe asistencë mbi të gjithë fondet publike të Europës.



5

European Commission Research & Innovation

Directorate-General for Research & Innovation është Drejtoria e Përgjithshme e Kërkimit dhe Inovacionit, pranë Komisionit Europian. Kjo drejtori aktualisht drejtohet nga Robert-Jan Smits. Misioni i saj është të zhvilloj dhe implementojë politikat Europiane të kërkimit dhe inovacionit për të arritur objektivat e “Europe - 2020” dhe Innovation Union. DG R&I kontribuon për ta bërë Europën një vend më të mirë për të jetuar dhe punuar, si dhe për përmirësimin e aftësisë konkurruese të Europës. Kjo drejtori mbështet kërkimin dhe inovacionin nëpërmjet Programeve Kuadër Europiane, koordinon dhe mbështet kërkuesit rajonal dhe nacional, kontribuon në krijimin e European Research Area, duke zhvilluar koordinimin midis kërkuesve. Gjithashtu, mbështet organizatat Europiane dhe kërkuesit në bashkëpunimin e tyre, në nivel ndërkombëtar. Kjo drejtori e përgjithshme është e organizuar në disa nëndrejtori, në varësi të fushës së kërkimit. Në linkun <http://ec.europa.eu/research/index.cfm?pg=org&lg=en> do të gjeni ndarjen sipas drejtorive dhe në linkun do të gjeni hartën e organizimit:

http://ec.europa.eu/research/dgs/pdf/organisation_en.pdf#view=fit&pagemode=none.

European Commission Research & Innovation (Figura 1) është faqe web, projektuar për t’u ardhur në ndihmë çdo personi që do të informohet mbi kërkimin në Europë. Çdo person, qoftë kërkues, ose një pedagog, një politikan apo një person nga biznesi, mund të gjejë informacion në këtë platformë web. Në këtë faqe mund të gjeni vendimet politike dhe të rejat e fundit në fushën e kërkimit. Siti ka më shumë se 30.000 faqe, ku ju mund të gjeni gjithçka që ju intereson. Në vazhdim do të përshkruhen menyte kryesore ku ju mund të gjeni informacion në këtë platformë web.

Ju mund të gjeni një guidë të detajuar të kësaj platforme në Menynë, në të djathtë të faqes Guide tour, ose në linkun : <http://ec.europa.eu/research/flash/tour.cfm?lg=en>. Kjo faqe është pjesë e portalit “Europa” të Komisionit Europian, ku ju mund të informoheni për çdo aspekt të politikave dhe aktiviteteve të Bashkimit Europian.

Faqja e kërkimit është konceptuar si një burim aksesimi informacioni, për sa më shumë njerëz, për kërkimin europian, në të gjitha gjuhët zyrtare të Bashkimit Europian. Por, gjithsesi, faqja me informacion me të specializuar dhe detajuar është në anglisht.



Figura 1: Faqja Web e European Commission Research & Inovation

Duke naviguar në këtë faqe, ju mund të shikoni dhe të gjeni të gjithë faqet e Programeve Konturë të Kërkimit që janë në operim për momentin, por edhe ato që kanë qenë më parë. Gjithashtu, këtu do të gjeni informacion mbi politikat

e kërkimit dhe inovacionit të Komitetit European, njoftimet dhe aktivitetet që zhvillohen në këtë kuadër.

Faqja kryesore e këtij siti konsiston në një seksion qendror, në të cilin publikohen njoftimet e reja, të rifreskuara çdo ditë. Kemi tri meny kryesore në faqe:

- ◆ Është menyja në fillim të faqes, menyja në të majtë dhe ajo në të djathtë.

Menyja kryesore

Në Figurën 2 tregohet menyja kryesore e kësaj faqe web, e cila përbëhet nga disa nën- meny të cilat përshkruhen, si më poshtë.



Figura 2: Menuja Kryesore e ECR&I

[Find Funding](#); duke klikuar mbi këtë nën-meny, ju do të kaloni në faqen e Participant Portal që është një portal informacioni, REA – Research Executive Agency, ERC – Eurorean Research Council, dhe në faqet e Programeve Kuadër FP7, FP6, FP5 dhe FP4.

[Reserach Policy](#); në këtë nën-meny janë përmbledhur të gjithë linket e faqeve web që lidhen me politikat Europiane të kërkimit.

[Information](#); në këtë nën-meny janë përmbledhur linket e të gjithë faqeve web që kanë informacion lidhur me kërkimin, ku përfshihen eventet dhe publikimet, deklaratat për shtyp dhe gazetat. Gjithashtu aty do te gjeni dhe [Research Information Center](#) ku janë përmbledhur artikuj nga të gjithë sitet e kërkimit, të organizuar sipas subjektit.

[Area of research](#); kjo nën-meny përmban listën e fushave të kërkimit të lidhura me faqet web të çdo fushe. Kjo është një faqe shume e dobishme për të marrë informacion, për fushën tuaj të interesit.

[About this site](#); kjo nën-meny përmban informacionin informues mbi këtë platformë web, arsyen e krijimit, çfarë është kjo platformë dhe informacione të tjera.

[What's new](#); përmban informacione të rifreskuara çdo ditë për kërkimin. Gjithashtu në të do të gjeni dhe informacionet dhe njoftimet që janë bërë muaj, apo vite më parë.

[Successes in Science](#); do te gjeni historitë e suksesit të projekteve të financuar nga Bashkimi Europian. Këtu mund të gjeni opinione dhe eksperiencën e pjesëtarëve të projekteve të Kërkimit dhe Inovacionit Europian.




Figura 3: Menuja e ECR&I

të dërgoni pyetjen tuaj personave të kontaktit, për të marrë një informacion mbi projekte, apo politikat e kërkimit në Europë.

Në menyën “Receive [RSS](#)” ju mund të nënshkruheni për të marrë të gjithë njoftimet e reja që publikohen në këtë platformë web.



Kërkimi për informacion

Kjo platformë ofron disa mënyra për të kërkuar informacion (Figura 3):

- ◆ Duke kërkuar në fushën e kërkimit me anë të fjalëve kyçe, në fushën e kërkimit “Search”.
- ◆ Duke kërkuar me anë të indeksimit ([Index](#)). Në këtë formë kërkimi, ofrohen rreth 9000 fjalë kyçe dhe ju mund të gjeni informacion që lidhen me këto fjale kyçe.
- ◆ Duke kërkuar informacion, nëpërmjet hartës së platformës ([Site map](#)). Në këtë link jepet në mënyrë të detajuar e gjithë harta e informacionit, që përmban platforma.

Nëse ju keni pyetje, mund t’i drejtoheni menysë: “Ask”, e cila ka dy nën - menu: [FAQ](#) dhe [Enquiry Service](#).

[FAQ](#) - nëpërmjet kësaj forme ju mund të gjeni informacion të ndarë në fusha dhe subjekte.

[Enquiry Service](#) – nëpërmjet kësaj forme ju mund

Bashkimi Europian në Vendin tuaj

The EU in your country (Bashkimi Europian në vendin tuaj) është menyja ku ju mund të informoheni rreth [Kërkimit Europian sipas Vendeve](#), [Shtetet pjesëmarrëse në Bashkimin Europian](#) dhe [Rreth Botës](#).

Figura 4:
Menuja BE në vendin tuaj



Figura 5: Menyja “Kush jeni Ju?”

Një faqe dedikuar secilit prej jush: (Who are you?)

Kjo është një pjesë shumë interesante e kësaj platforme. Informacioni ndahet sipas profesionit dhe fushës që ju i përkisni, në mënyrë që çdo i interesuar ta ketë më të lehtë të marri vetëm informacionet që lidhen me fushën e tij të kërkimit apo me profesionin e tij. Në këtë meny do të gjeni informacion të ndarë sipas profesionit që ju keni: [Kërkues](#), [Gazetar](#), [Student](#), [Mësues](#), [NGO](#), [Politikan](#), [Biznes](#) apo [Publik i përgjithshëm](#).



Figura 6: Menyja Press Center

Press Center dhe Linke të Kërkimit

Në këtë faqe do të gjeni linke për gazeta dhe portalet informative të Kërkimit në Europë. Këtu çdo ditë do të gjeni një artikull të ri për një zhvillim të rëndësishëm kërkimor shkencor në Europë. Gjithashtu do të gjeni dhe artikujt që janë publikuar më parë.

[Press Center](#); rifreskohet rregullisht me informacionet dhe njoftimet rreth çdo projekti, ngjarje apo politike zhvillimi. Disa prej tyre mund t'i gjeni në disa gjuhë.

[News](#) – Njoftimet e reja

[Event Diary](#) - Ditari i përmbledhur i eventeve, ngjarjeve dhe aktiviteteve, i të gjithë Programeve dhe Organizatave të Kërkimit European.

[Who's who in Research?](#) - Në këtë pjesë të faqes listohen disa nga organizatat më të rëndësishme të kërkimit. Duke vizituar faqen, ju mund të merrni më shumë informacion.

Në linkun <http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/home> do të gjeni informacione mbi pjesëmarrësit në projekte.

Në linkun <http://ec.europa.eu/research/index.cfm?lg=en&pg=who&cat=a&tips=on> do të gjeni informacion, të ndarë sipas fushave të kërkimit. Në linkun <http://ec.europa.eu/research/rea/> do të gjeni informacion mbi REA - Research Executive Agency, që është agjencia që merret me menaxhimin e fondeve. Nëse vizitoni këto faqe do të merrni dhe informacione të tjera të dobishme.

Portali i Pjesëmarrësve

[Participant Portal](#) është entiteti elektronik i menaxhimit i projekteve të kërkimit dhe inovacionit të financuara nga Bashkimi Europian. Në të janë të postuara të gjitha shërbimet për menaxhimin e propozimit dhe projektit, gjatë gjithë fazave të zhvillimit të tij. Aktualisht ky portal mbulon të gjithë veprimtarinë e Programit FP7. Në të ardhmen ai do të përfshijë dhe projekte të tjera të kërkimit dhe inovacionit. Ju do të gjeni një guidë përdorimi të faqes në mënyrë elektronike: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/ShowDoc/Participant+Portal/portal_content/help/participant_portal_usermanual.pdf. Kjo është faja e vetme në Komisionin Europian ku publikohen thirrjet për projektet në të ardhmen.

The screenshot shows the 'Participant Portal' interface. At the top, there's a navigation bar with 'Home', 'My Organisations', 'FP7 Calls', and 'Support'. The main content is titled 'WELCOME' and includes a 'Login' button. Below this, there's a 'NEED HELP?' section with links to user manuals and FAQs. The 'WELCOME' section contains a 'Welcome to the Participant Portal' message, followed by 'What does it offer today?' which lists features like searching for FP7 calls, managing projects, and accessing organizational data. Below that is 'Forthcoming functionalities' and 'How does it work?' which is a four-step process: 1. Basic functions for anonymous users, 2. New system replacing the old one, 3. Authorization and access to data, 4. Contextual menu for additional actions. At the bottom, there are logos for the European Union, FP7, and Research Site.

Figura 7: Portali i Pjesëmarrjes

Menyja Kryesore

Menyja kryesore e kësaj faqe web përbëhet nga disa nën-meny. Në menynë “Home” ju do të gjeni informacione hyrëse mbi këtë faqe.

Menyja “My Organisations” shërben për të regjistruar një organizatë të re, për të gjetur një organizatë nëpërmjet kërkimit sipas emrit, shtetit dhe qytetit dhe FLV Simulation për të simuluar financimin e projektit tuaj.

Në menynë “FP7 Calls” do të gjeni njoftimet më të reja për thirrjet e programit FP7, të ndara sipas fushave që ka FP7, Cooperations, Ideas, People, Capacities Euroatom dhe JRC. Gjithashtu aty ekziston një formë kërkimi e avancuar për thirrjet. Ju do të gjeni thirrjet që janë akoma të hapura, ato në gjendje të mbyllur dhe ato që do të hapen në të ardhmen.

Menyja “Support”; do të gjeni informacion ndihmës mbi navigimin në faqe, një tab me njoftimet e reja, një faqe për të kontaktuar me përfaqësuesit e portalit, hartën e faqes dhe njoftimet.




Figura 8: Need Help?

Kërkimi për informacion

Menyja “Need Help?”; në të do të gjeni informacione që do t’ju ndihmojnë për të kërkuar në këtë faqe. Duke përfshirë një [guidë kërkimi](#) në faqe, ku mund t’i jepni përgjigje çdo pyetje që keni. Kështu, mund t’i jepni përgjigje pyetjeve tuaja duke konsultuar [FAQS](#). Nëse ju keni një pyetje apo dëshironi të merrni informacion mbi një çështje që nuk përfshihet në faqet e mësipërme, mund të kontaktoni me shërbimin “e” [FP7 Service Desk](#), që mirëpret çdo pyetje tuajën.





Figura 9: Të rejat

Të rejat

“What’s new” është një tabelë e vogël ku publikohen njoftimet dhe ngjarjet e reja që kanë lidhje me kërkimin në Europë.

Gjithashtu ekziston dhe një set fletushkash on-line për kërkimin në Europë, dedikuar jo-specialistëve në 11 gjuhë dhe i gjeni në linkun: http://ec.europa.eu/research/leaflets/index_en.html.

Ky entitet ka dhe një revistë elektronike “[Research*eu](#)” ku: shfaqet çdo informacion dhe njoftim, e cila është në 4 gjuhë anglisht, frëngjisht, gjermanisht dhe spanjisht.



6

CORDIS

CORDIS - Community Research and Development Information Service është një portal interaktivë me adresë <http://cordis.europa.eu>, që mbështet bashkëpunimin në fushën e kërkimit, teknologjisë dhe inovacionit në Europë. Kjo është platforma web për të gjitha Programet Europiane të Kërkimit dhe Zhvillimit. “CORDIS” është një platformë shumë -gjuhëshe (anglisht, frëngjisht, italisht, spanjisht dhe polonisht) që lidh kërkuesit, politikbërësit, sipërmarrësit dhe qytetarët e thjeshtë për të bashkëpunuar. Por duhet theksuar se shumica e përmbajtjes shkencore është vetëm në gjuhën angleze.


Qëllimet kryesore të “CORDIS” janë:

- ◆ Lehtësimi i pjesëmarrjes në aktivitetet e kërkimit në Europë, veçanërisht në Programin FP7 (Programi Kuadër 7);
- ◆ Publikimin e rezultateve të projekteve të financuara nga Bashkimi Europian;
- ◆ Nxitjen e përhapjes së informacioneve në mënyrë që të forcohen kapacitetet novatore të ndërmarrjeve dhe biznesit;
- ◆ Lehtësimin në kapërcimin e hendekut midis qytetarëve dhe shkencës;
- ◆ Të përmirësojë përhapjen dhe shfrytëzimin e rezultateve të kërkimeve shkencore në Europë.

Shërbimet dhe Aktivitetet

“CORDIS” ofron një gamë të gjerë informacionesh të detajuara dhe shërbimesh në lidhje me Kërkimin në Bashkimin Europian, ku përfshihen:

- ◆ Vend-ruajtja primare e projekteve të kërkimit të financuara nga Bashkimi Europian që nga viti 1990, ku përfshihen dhe formal deliverables, të mbledhura nga Komisioni Europian;
- ◆ Njoftimet ditore, ngjarjet, financimet dhe research showcases, të publikuara nga Komisioni Europian dhe nga përdoruesit e tjerë;
- ◆ Një mjedis interaktivë për të gjetur partnerë në kërkimin shkencor;
- ◆ Shumë shërbime tematike, pikat kombëtare të kontakteve, një bibliotekë dokumentesh, udhëzime përdoruesish dhe mjete për një kërkim sa më të



lehtë të informacionit ku përfshihen dhe njoftimet nëpërmjet email-it dhe RSS feeds;

- ◆ Baza të dhënash dhe shërbime për të mbështetur aktivitetet kërkimore në Europë.

Organizimi dhe baza ligjore

“CORDIS” u krijua në vitin 1990, pas një Komunikate të Komisionit për Implementimin e Shërbimit: “Informimi RTD” (SEC (1988)1831). Ky shërbim ofrohet on-line që nga viti 1994. Baza aktuale ligjore ku mbështetet “CORDIS” është [Vendimi Nr. 1982/2006EC](#), i Parlamentit European dhe vendimi i datës 16 Dhejtor 2006, i Këshillit në lidhje me Projektin Kuadër Shtatë të Komunitetit European, për kërkimin, zhvillimin teknologjik dhe aktiviteteve demonstrative (2007-2013).

“CORDIS” që nga viti 2004 menaxhohet nga Zyra e Publikimeve të Bashkimit European (Publication Office of the European Union) në emër të Drejtorisë së Përgjithshme të Kërkimit dhe Inovacionit të Komunitetit European dhe në bashkëpunim me shërbime të ndryshme të Institucioneve të Bashkimit European, agjenci dhe organe që përfshihen në aktivitetet e kërkimit shkencorë. Ajo financohet nga Programi Bashkëpunim (Cooperation) i Programit Kuadër 7 (FP7) për Kërkimin dhe Zhvillimin Teknologjik.

“CORDIS” bashkëpunon me të gjitha shërbimet që përfshihen gjatë ekzekutimit të projekteve të kërkimit të financuara nga Bashkimi European.

Kush janë ofruesit e informacionit dhe të interesuarit?

“CORDIS” përfshin një gamë të gjere informuesish dhe të interesuarish. Ofruesit e Informacionit mund të gjenden në nivele rajonale, nacionale dhe Europiane. Kurse të interesuarit mund të jenë organizatat e kërkuesve, administrata publike dhe grupe të specializuara.

Në nivel European, informatorët janë Komisioni European dhe persona të zgjedhur që ofrojnë vazhdimisht informacione mbi programet dhe aktivitetet e kërkimit.

Ofruesit e Informacionit dhe të Interesuarit për Informacion




Figura 10: Ofruesit e Informacionit dhe të Interesuarit për Informacion

Çfarë mund të publikohet në "CORDIS"?

"CORDIS" është një hapësirë informacioni për aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit evropian. Çdo ditë, shtohet informacion i ri dhe çdo material tjetër rifreskohet dhe rishikohet, derisa kalon në arkiv (ku ai mbetet në dispozicion të përdoruesve). Informacioni i publikuar në "CORDIS" mund të kategorizohet si më poshtë:

- ◆ Aktivitetet e kërkimit të Bashkimit Evropian – Është një shërbim informativ mbi çdo aspekt të programeve R&D, politikave dhe iniciativave të tjera të Bashkimit Evropian. Objektivi i tyre është ofrimi i asistencës për organizatat dhe individët, në pjesëmarrjen dhe përfitimin e fondeve të kërkimit shkencor të Komunitetit.
- ◆ Aktivitetet e kërkimit Pan-Europiane dhe Internacionale - Shërbime për të promovuar politikën e kërkimit dhe inovacionit, programet dhe infrastrukturën e shteteve anëtarë. Informacion rreth Pan-European frameworks, shërbime për të promovuar aktivitetet e bashkëpunimit me shtetet e asociuara dhe vendet e tjera të treta.

Cili është roli dhe përgjegjësia e ofruesit të informacionit?

Ofruesi i informacionit është një person i vendosur nga organizata përkatëse për të shërbyer si pikë kontakti me "CORDIS" për të gjitha çështjet që lidhen

me **përmbajtjen** e publikuar në faqen e “CORDIS”. Informatori duhet të jetë në kontakt me CORDIS për çështjet e mëposhtme:

- ◆ **Mirëmbajtjen** e përmbajtjes: Informatori duhet të mirëmbaje informacionin që ka publikuar në “CORDIS”. Mirëmbajtja përfshin çdo tip rifreskimi, shtimi dhe fshirje të informacionit.

The screenshot shows the CORDIS website interface. At the top, there is a navigation bar with links for 'About CORDIS', 'Print', 'Legal Notice', 'Search', and 'Contact'. Below this is the European Commission logo and the CORDIS title. The main header includes 'Welcome to the CORDIS Website' and a search bar. The content is organized into several columns: 'Do not miss' with various news items, 'Research Funding' featuring the 7th Framework Programme, 'Events' listing upcoming conferences, 'Latest news and publications' with a featured article on EU-funded research infrastructure, 'Researchers' Corner' with various services, and 'Business & Innovation' with a network logo. The footer contains a sitemap, glossary, and contact information.

Figura 11: Faqja Web e CORDIS

- ◆ Copyright: Çdo përmbajtje grafike, ose logo e publikuar në “CORDIS” duhet të ketë të drejtën e autorësisë dhe lejen për publikim nga pronari. Në rast mashtrimi, “CORDIS” është i detyruar të lidhet me informatorin për sqarime.

Shërbimet e publikimit të ofruara nga “CORDIS”

“CORDIS” mund t’ju ndihmojë në ndërtimin dhe zhvillim e faqes suaj web. Shërbimet e publikimit që përfshihen ndahen në tre kategori:

- ◆ Shërbime -web (faqe statike dhe dinamike)
- ◆ Shërbime- bazë të dhënash (rekorde të ruajtura në një bazë te dhënash)
- ◆ Aplikacione (psh: forma on-line, forume on-line)

Nëse juve ju nevojitet postim i faqes, “CORDIS” mund të realizojë këtë gjë për ju.

“CORDIS” është një platformë pa pagesë dhe siguron akses në aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit në Europë, siguron informacion për të gjetur partnerë dhe informacione mbi projektet e zhvilluara dhe ato në zhvillim. “CORDIS” dot t’ju asistojë, kushdo që ju jeni: një kërkues, një qytetar, një përfaqësues biznesi, politikan, një agjenci qeveritare, një organizatë jofitimprurëse, një gazetar, një pikë kyçe në fushat R&D dhe inovative. “CORDIS” ofron përmbajtje të lirë dhe përdorim të lirë. Siç e përmendëm dhe më lart, faqja web e “CORDIS” ndodhet në linkun : http://cordis.europa.eu/home_en.html si në Figurën 12.

Menyja kryesore





Figura 12: Menuja Kryesore e CORDIS

Menyja kryesore përbëhet nga këto nën-meny: [Home](#), [News](#), [Funding](#), [Results](#), [Partners](#) dhe [Go local](#) të cilat do t’i shtjellojmë më poshtë:

[Home](#) – është faqja e parë e platformës “CORDIS”. Në faqen kryesore të kësaj platforme do të gjeni linkun për tek FP7 – Programi Kuadër 7, për tek programet e mëparshme, FP6 - FP5 – FP4, për tek guida praktike e fondeve të Bashkimit Europian dhe linkun e ERA – European Research Area.

Poshtë kësaj pjese publikohen lajmërimet dhe publikimet e reja, ku ju mund të informoheni mbi aktivitete, punimet dhe ecurinë e zhvillimit të shkencës. Në



menynë në të djathtë, publikohen të gjitha ngjarjet e ardhshme si: konferenca, forume, takime etj. Poshtë tyre ndodhet qoshja e kërkuesve ku ju mund të gjeni linket e disa prej forumeve dhe platformave të tjera që merren me Kërkimin dhe Zhvillimin Teknologjik në Europë.

News – “CORDIS News” është një shërbim shumë gjuhësh ku informoheni mbi të rejat më të fundit në botën europiane të kërkimit, duke përfshirë dhe gjetjen e mundësive të financimit dhe aktivitetet që organizohen. Si çdo informacion tjetër, në “CORDIS” dhe këto informacione ju mund t’i merrni nëpërmjet shërbimit RSS dhe email-it. Në këtë faqe publikohen njoftimet dhe ngjarjet ditore, në gjashtë gjuhë. Kërkuesit mund të publikojnë njoftimet e tyre nëpërmjet “Cordis Wire”. “CORDIS WIRE” mund të marrë direkt mesazhin tuaj nga çdo komunitet R&D në Europë dhe më tej. Kjo platformë interaktive shërbimesh ju ofron:

- ◆ Promovimin e aktiviteteve dhe shpërndarje të informacioneve;
- ◆ Komunikim dhe krijim kontaktesh në nivel Europian;
- ◆ Leximin e lajmeve, historive të suksesit, evente dhe raporte.


Funding – Kjo është faqja për programet FP7 që do të flitet në kapitullin pasardhës. Aty ju do të gjeni të gjithë informacionin mbi këtë program.

Projects – “CORDIS” është depoja kryesore për projektet R&D të kërkimit, shkencës dhe teknologjisë të financuara nga Bashkimi Europian. Në bazën e të dhënave të këtij sistemi ruhen dokumentet që datojnë që nga viti 1990, jo vetëm të Programit Kuadër shtatë, por edhe dokumenta të programeve të mëparshme Kuadër. Projektet publikohen në “CORDIS”, pasi ato janë bërë të vlefshme për të, nga Komisioni përgjegjës. “The Project” përdor bazën e të dhënave të “CORDIS” për të siguruar një shumëllojshmëri informacioni, të lidhur me projektet individuale, duke përfshirë:

- ◆ Detajet, përshkrimin, financimin dhe programin e projektit;
- ◆ Rezultatet, dokumentet, raportet dhe përmbledhjet e projektit;
- ◆ Pjesëmarrësit e projektit;
- ◆ Linket;
- ◆ Publikimet;
- ◆ Multi-media.

Ky shërbim e bën shumë të thjeshtë kërkimin e informacioneve për projektet.

Results - “CORDIS” është faqja e vetme dhe e përbashkët e Komisionit Europian për publikimin e rezultateve të projekteve të kërkimit të financuara nga Bashkimi Europian. Shërbimi “CORDIS -Results” ofron informacion rreth rezultateve të



projekteve aktuale R&D të cilat i jepen “CORDIS” nga Komisioni i Shërbimeve. Faqja ofron një mënyrë të thjeshtë për të gjetur rezultatet e çdo projekti kërkimi të financuar nga Bashkimi European. Shërbimi i ndihmës së kërkimit ju ndihmon të gjeni informacionin e duhur. Për çdo projekt FP6 ju mund të gjeni raportin final të aktivitetit. Për çdo projekt FP7 ju mund të gjeni përmbledhjen origjinale, raportet periodike dhe finale. “CORDIS” gjithashtu përgatit një përmbledhje të rezultateve të projekteve në të gjithë gjuhët që ofrohet platforma.

Partners - “CORDIS Partner Service” është një platformë interaktive dhe një shërbim me mjete kërkimi dhe filtrimi të thjeshta, për të gjetur partnerët dhe bashkëpunëtorët më të mirë në përputhje me nevojat tuaja. Suksesi i një projekti varet nga ndërveprimi dhe bashkëpunimi i partnerëve. Duke ofruar informacione, publikime shkencore, lajme dhe çdo gjë tjetër, “CORDIS Partner Service” ju ndihmon të kurseni kohë dhe energji, duke ju lidhur me mijëra kolegë në mbarë Europën e më gjerë. “CORDIS Partners” është një platformë bashkëpunimi për promovimin e ekspertizën dhe organizimin, për krijimin e grupeve dhe rrjeteve të bashkëpunimit dhe për gjetjen e parterëve në biznes, ose kërkim.

Kërko partnerët dhe planifiko një projekt:

- ◆ Lidhni idetë tuaja me thirrjet e hapura dhe krijoni kërkesa për partneritet;
- ◆ Ofroni eksperiencën tuaj;
- ◆ Gjeni lidhjet më të mira me kërkimin e avancuar;
- ◆ Krijoni, bashkohuni dhe merrni pjesë në rrjete dhe grupe interesi;
- ◆ Gjeni rekomandime.

Ndërveproni dhe performoni:

- ◆ Menaxhoni hapësirën tuaj të diskutimit; (grupet dhe projektet);
- ◆ Shkëmbeni dokumente nëpërmjet bibliotekës;
- ◆ Menaxhoni dhe organizoni takime nëpërmjet kalendarit;
- ◆ Merrni njoftimet nëpërmjet shërbimit RSS dhe e-mail-it;
- ◆ Postoni në blog tema me interes.
- ◆ Eksportoni dhe importoni të dhëna për t'i ripërdorur;
- ◆ Rekomandoni projekte, profile, etj.

Go local - Zbuloni se çfarë po ndodh pranë jush.

“CORDIS National R&D Service”, thekson politikat kombëtare dhe kornizat në të cilat kërkimi po zhvillohet në çdo shtet, anëtar i Bashkimit European, dhe në shtetet kandidatë, si dhe lajmet e fundit dhe arritjet kombëtare në fushën e R&D. Objektiv i kryesorë i “Regional Services” është të paraqes informacione rajonale

mbi aktivitetet R&D, duke u fokusuar kryesisht në aktorët rajonalë dhe lokalë (SME, universitetet, agjencitë shtetërore)

Do not miss	
New Projects Service launched on CORDIS	new
The PDF version of the Practical Guide has been updated and can be downloaded as a document in English	new
Read the latest Results feature stories from EU funded projects	new
research*eu focus magazine on Danube Strategy in English, French and German	new
More news	

Mos humbisni

Në të djathtë të faqes kryesore të “CORDIS” do të gjeni pjesën “Do not miss” në të cilën shfaqen njoftimet e reja dhe shumë të rëndësishme që kjo platformë ofron. Kjo lehtëson dhe ju vë në dijeni për aktivitete më të reja.

Listën e plotë të njoftimeve do ta gjeni në linkun: http://cordis.europa.eu/news/home_en.html

Figura 13:
Menuja “Do not miss” e CORDIS

Events
‘ACQUEAU call 5 brokerage event’, Brussels, Belgium [Event Date: 2012-01-24]
Sixth International Workshop on Variability Modelling of Software-Intensive Systems, Leipzig, Germany [Event Date: 2012-01-25]
Fifth Advances Against Aspergillosis Conference, Istanbul, Turkey [Event Date: 2012-01-26]
‘Material efficiency: providing material services with less material production’, London, UK [Event Date: 2012-01-30]
Third International Workshop on Medical Image Analysis and Description for Diagnosis System, Algarve, Portugal [Event Date: 2012-02-01]
All events

Evente dhe aktivitete


Në të djathtë të faqe kryesore të “CORDIS” do të gjeni hapësirën e dedikuar eventeve dhe aktiviteteve që organizohen në kuadër të programeve të ndryshme të kërkimit nga agjenci të ndryshme që operojnë në këtë fushë.

Listën e plotë të eventeve dhe ngjarjeve do ta gjeni në linkun: http://cordis.europa.eu/fetch?CALLER=EN_NEWS_EVENT

Figura 14:
Menuja Evente e CORDIS

Revistat

Revista “[Research*eu results](#)” publikon lajmet dhe informacionet më të fundit nga kërkimi dhe zhvillimi european. Kjo revistë publikohet dhjetë herë në vit, në anglisht, siguron rifreskimin e informacioneve të projekteve të kërkimit të financuara nga Bashkimi European, duke theksuar teknologjitë e reja.




Revista “[Research*eu fokus](#)” është një revistë ku çdo botim, mbulon një temë të caktuar me interes për kërkuesit, politikbërësit dhe aktorët e tjerë në fushën e kërkimit. Ajo përmban artikuj mbi politikën, nismat, programet dhe projektet e kërkimit dhe zhvillimit të teknologjisë dhe inovacionit në Bashkimin Europian. Kjo revistë botohet nga “CORDIS” periodikisht dhe zakonisht në anglisht, por disa numra të saj mund të jenë edhe në gjuhë të tjera europiane. Kjo revistë është pa pagesë dhe ju mund të porosisni një kopje të saj nëpërmjet librisë EU (EU Bookshop);, me adresë: bookshop.europa.eu

Rrjeti i Pikave Kombëtare të Kontaktit

“CORDIS” siguron akses tek rrjeti i pikave kombëtare të kontaktit. Këto janë struktura të specializuara, në nivel kombëtar, ose lokal dhe ofrojnë udhëzime të personalizuara për:

- ◆ Prioritete dhe instrumente tematikë të rëndësishëm;
- ◆ Procedura administrative dhe çështje kontraktuale;
- ◆ Asistencë për gjetjen e partnereve;
- ◆ Kontakte lokale për transferimin e teknologjive.

Gjeni me shumë linke në shërbimin e suportit të FP7 në : cordis.europa.eu/fp7/get-support_en.html



7

FP7 - Seventh Framework Programme for Research and Technological Development - Programi Kuadër Shtatë për Zhvillimin e Kërkimit dhe Teknologjisë.

FP7 - Seventh Framework Programme for Research and Technological Development - Programi “Kuatër Shtatë për Zhvillimin e Kërkimit dhe Teknologjisë” vepron në periudhën kohore: 2007 – 2013 dhe ka buxhet total prej 50.521 milion Euro.

Programi “Kuatër Shtatë për Zhvillimin e Kërkimit dhe Teknologjisë”, FP7, është instrumenti kryesor i Komunitetit European për financimin e aktiviteteve të kërkimit dhe zhvillimit të teknologjisë, në çdo fushë të shkencës, në veçanti, duke nxitur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, qendrat kërkimore dhe universitet në veprimtarinë e tyre të kërkimit dhe të zhvillimit të teknologjisë. FP7 nuk ka vetëm si qëllim financimin e projekteve të kërkimit, por merret dhe me mbështetjen dhe koordinimin e kërkuesve.

“CORDIS”, siç u përmend dhe në kapitullin paraardhës, është portali zyrtar, ku publikohen të gjitha zhvillimet dhe aktivitetet e shkencës dhe teknologjisë në Europë dhe vendi ku mund të aplikohet dhe të merren informacione mbi Programin FP7.

Objektivat

Programi FP7 ka si objektiv kryesor forcimin e bazës shkencore dhe teknologjike të industrisë europiane. Një objektiv tjetër është arritja e një niveli të lartë të konkurrencës, në nivel ndërkombëtar, në kërkim dhe teknologji, duke u bazuar në politikat e Bashkimit European për të krijuar një sinergji europiane të kërkimit.

Struktura

Programi FP7 përbëhet nga programe specifike. Këto programe janë listuar më poshtë dhe janë të vlefshme për periudhën 2007 - 2013.


Struktura dhe Ndarja e Buxhetit të Programit FP7 të Kërkimit

Cooperation	Ideas	People	Capacities
Collaborative	Frontier	Career	Building
Researche	researche	debelopment	infrastructure
B. 32,413 milion €	7,460 milion €	4,727 milion €	4.291 milion €

Programi “[Cooperation](#)” - “[Bashkëpunimi](#)” përfshin 2/3 e FP7 dhe fokusohet në zhvillimin dhe promovimin e bashkëpunimit midis kërkuesve në Europë dhe shteteve të tjera partnere, nëpërmjet projekteve trans-nacionale. Ky program përfshin 10 fusha kërkimi të cilat financojnë në:

1. Shëndetësi;
2. Ushqim, bujqësi, peshkim dhe bioteknologji;
3. TIK - Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit;
4. Nano - shkencë, nano -teknologji, materiale dhe teknologjitë e reja të prodhimit;
5. Energji;
6. Mjedis (ndryshmet klimaterike);
7. Shkencat social-ekonomike dhe humane;
8. Hapësirë;
9. Siguri.

Programi “[Ideas](#)” - “[Idetë](#)” financon idetë më novatore dhe të spikatura të kërkimit shkencor. Ai mbështet “frontier research” mbi bazën e inteligjencës shkencore. Projektet në këtë program lidhen me fusha të shkencës dhe teknologjisë, duke përfshirë projektet inxhinierike, në shkencat social-ekonomike dhe humanitare. Në këtë program nuk është e nevojshme të kemi partnerë ndërkombëtarë. Ky program implementohet nëpërmjet [ERC](#) “European Research Council”, Këshilli European i Kërkimit. “Këshilli European i Kërkimit” ka një pozicion unik në financimin e kërkimit shkencor european. ERC është një institucion lider në financimin e shkencës, që mbështet kërkimin në nivelet më të larta të ekselencës, duke operuar në standardet botërore. Në përputhje me Strategjinë e BE-së ‘EUROPA 2020’ për një rritje të shpejtë, të zgjuar dhe të qëndrueshme, ERC promovon ekselencën, dinamizmin dhe kreativitetin në kërkimin european, duke nxitur tërheqjen e kërkuesve dhe kompanive më të mira në Europë. Grantet ERC jepen për financime të skemave ‘*Provë e Konceptit*’ (Proof of Concept) që themelojnë potencialin inovator të ideve. Këto aktivitete zbatohen nëpërmjet Aksioneve Koordinuese dhe Mbështetëse.



Programi “[People](#)” - “[Njerëzit](#)”, synon shkëmbimin e eksperiencave, trajnime, rritjen profesionale dhe zhvillimin e kërkimit shkencorë nëpërmjet lëvizjes së kërkuesve nga një vend në tjetrin. Ky program implementohet nëpërmjet aksioneve të ndryshme, të quajtura “[Marie Curie Actions](#)” - “([Aksionet Marie Curie](#))”, të cilat ndihmojnë dhe mbështesin kërkuesit në zhvillimin e tyre profesional. Për aksionet “Marie Curie” do të flitet më në detaje në pjesën në vazhdim. Aksionet “Marie Curie” janë:


- ◆ Trajnime për kërkuesit (rrjeti Marie Curie);
- ◆ Partneritete akademike;
- ◆ Bashkëfinancimi rajonal, nacional dhe programet e lëvizshmërisë ndërkombëtare të kërkuesve;
- ◆ Dimensione ndërkombëtare: bursa, skema ndërkombëtare bashkëpunimi dhe grande ri-integrimi.

Programi “[Capacities](#)” - “[Kapacitetet](#)” - nuk financon kërkimin në vetvete, por ngritjen dhe rritjen e kapaciteteve për kërkimin shkencor. Ky program synon të ndihmojë në zhvillim e ekonomisë së Europës duke u bazuar në qëllimet e përcaktuara në Strategjinë e Lisbonës. Programi “Kapacitetet” mbulon aktivitete në fushat e mëposhtme:

- ◆ Infrastrukturën e kërkimit;
- ◆ Kërkimi në dobi të SME- ve;
- ◆ Rajonet e dijës;
- ◆ Potencialet e kërkimit;
- ◆ Shkenca në shoqëri.

Programi “[Euratom](#)” është një program specifik me buxhet të veçantë. Aktivitetet e kërkimit të “Euratom” organizohen dhe menaxhohen nga një buxhet i veçantë. “Euratom” ka programin e vetë të kërkimi dhe buxhet prej 2751 milion Euro për periudhën 2007-2011. “FP7 Euratom” është i ndarë në dy programe specifike: një që mbulon në mënyrë indirekte fushat e kërkimit të energjisë nukleare dhe mbrojtjen nga rrezatimet radioaktive, kurse programi tjetër, merret drejtpërdrejt me veprimtarinë në fushën e energjisë bërthamore që realizohet nga JRC - Joint Research Centres - Qendra të Përbashkëta Kërkimi.

“[JRC-Joint Research Centre](#)” - “[Qendra të Përbashkëta Kërkimi](#)” - Janë ngritur 7 Qendra të Përbashkëta Kërkimi, misioni i të cilave është të sigurojnë mbështetje shkencore dhe teknike për konceptimin, zhvillimin implementimin dhe monitorimin e politikave Europiane. 7 JRC-të janë:

- 
- ◆ IRMM- The Institute for Reference Materials and Measurements
 - ◆ ITU- The Institute for Transuranium Elements
 - ◆ IET- The Institute for Energy and Transport
 - ◆ IPSC- The Institute for the Protection and Security of the Citizen
 - ◆ IES- The Institute for Environment and Sustainability
 - ◆ IHCP- The Institute for Health and Consumer Protection
 - ◆ IPTS- The Institute for Prospective Technological Studies

Si të marrim dhe si t'i përdorim fondet e programit FP7?

FP7 implementohet përmes veprimtarive të ndryshme si: projekte bashkëpunimi, projekte kërkimi, të realizuara nga një konsorcium ndërkombëtarë, etj. Më poshtë, jepet një listë e veprimtarive që mbështeten financiarisht nga FP7-ta:

1. Kërkimi për përmirësimin e SME–ve (Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme): suporti ofrohet për projektet e kërkimit të realizuara nga universitete, ose qendrat e kërkimit si përfitim i grupeve specifike, veçanërisht SME-të (Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme).
2. Projektet e bashkëpunimit - këto janë projekte kërkimi të shkallëve të ndryshme, ku marrin pjesë përfaqësues nga vende të ndryshme dhe kanë për qëllim zhvillimin e njohurive, teknologjive, produkteve dhe burimeve të reja.
3. Rrjetet e ekselencës - këto janë programe bashkëpunimi për një periudhë të gjatë kohore, midis grupeve kërkimore që punojnë në programet e përbashkëta të kërkimit.
4. Veprime koordinimi dhe mbështetje; - mbështetja ofrohet për rrjetet e kërkuesve, shkëmbimin e eksperiencave, aksesin trans-nacional në infrastrukturat e kërkimit, për studime dhe konferenca për të koordinuar, ose mbështetur aktivitetet e kërkimit.
5. Projektet individuale; - mbështetja ofrohet për projektet e kërkimit të financuara nga Këshilli European i Kërkimit.
6. Mbështetje për trajnime dhe rritjen profesionale të kërkuesve; - mbështetja ofrohet për trajnime dhe rritjen profesionalisht të kërkuesve, kryesisht nga implementimi i aksioneve “Marie Curie”.

Programet e punës, guidat për aplikuesit dhe të tjera dokumente mbështetëse janë në dispozicion në faqen kryesore “FP7 dhe CORDIS”.



Kush mund të aplikoj në FP7?

Pjesëmarrja në Programin FP7 është e hapur për çdo organizatë dhe individ që merret me kërkimin dhe zhvillimin e teknologjisë. Më poshtë listohen pjesëmarrësit në FP7:

- ◆ Grupet e kërkimit të universiteteve, apo të qendrave kërkimore;
- ◆ Kompanitë që merren dhe sjellin ide dhe programe novatore;
- ◆ Organizata publike, ose qeveritare (në nivel lokal, rajonal ose kombëtare);
- ◆ Organizata, ose kërkues nga vendet e treta, organizata ndërkombëtare dhe organizata nga shoqëria civile.

“Programi FP7” është i hapur për organizatat nga çdo shtet i botës, pavarësisht se procedurat e pjesëmarrjes dhe financimit ndryshojnë në varësi të shtetit. Disa nga grupet janë: Shtete anëtare dhe vendet e Asociuara me FP7, vendet partnere në bashkëpunimin ndërkombëtar si: Rusia, vendet e Europës Lindore, vendet e Azisë Qendrore, Ballkani Perëndimor). Bashkëpunimit me Vendet e Treta, që janë jashtë sferës së Bashkimit European, u jepet vëmendje e veçantë në programin FP7.

Vendet e Asociuara në FP7 të cilët kanë nënshkruar “Memorandumin e Mirëkuptimit” dhe që kontribuojnë në buxhetin e FP7, mund të marrin pjesë dhe të marrin fonde njëjloj si shtetet anëtare. Aktualisht shtete të asocuara në FP7 janë: Vendet EEA, Zvicra, Izraeli, Turqia, Kroacia dhe Republika e Maqedonisë. Thirrje specifike hapen për ICPC - International Cooperation Partner Countries – Vendet “Ndërkombëtare -Partnere –Bashkëpunim”, të cilat janë Lowand, Middle- income dhe vendet jo anëtare të BE-së. Vendet ICPC marrin fonde të Shteteve Anëtare, kur marrin pjesë në thirrjet e programeve të “Bashkëpunimit dhe Kapaciteteve”.

Më shumë se gjysma e buxhetit të përgjithshëm të FP7 është ndarë në 10 fushat tematike të programit “Bashkëpunim” (shëndetësi, bujqësi, ushqimi, peshkimi dhe bioteknologji, TIK, Nanoshkenca dhe Nanoteknologjitë, materialet dhe teknologjitë e reja të prodhimit, energjisë, mjedisit, transportit, shkencave socio-ekonomike dhe humanitare, hapsirë dhe siguri). Financimi nga Komisioni European do të varet nga skema e financimit, lloji i aktivitetit, lloji i subjektit dhe vendndodhja gjeografike e partnerit dhe mund të jetë deri në 100% e kostove të pranueshme.

Baza Ligjore

Ky Program bazohet mbi Vendimin Nr. 1982/2006/EC të Parlamenti dhe Këshillit European, i datës 18 Dhjetor 2006 për “Programin Kuadër Shtatë” të Komunitetetit European për kërkimin dhe zhvillimin teknologjik 2007 - 2013.

Në tabelën e mëposhtme tregohet ndarja e buxhetit për programin FP7.

COOPERATION 32,365M€ 10 Thematic Areas	IDEAS 7,460M€	PEOPLE 4,728M€	CAPACITIES 4,217M€
Health 6,050M€	Supporting, investigator-driven research projects carried out across all fields	Strengthening the human potential in research and technology in Europe	Research Infrastructures 1,715M€
Agri & Bio 1,935M€		Initial Training of Researchers	Research for the benefits of SMEs 1,336M€
ICT 9,110M€		Life-long training & Career Development	Regions of Knowledge 126M€
NMP 3,500M€		Industry-academia pathways	Research Potential 340M€
Energy 2,300M€		International Dimension	Science in Society 330M€
Environment 1,900M€		Specific support action	International Cooperation 180M€
Transport (incl. AERO) 4,180M€			
Socio Economic Sciences and the Humanities 610M€			
Space 1,430M€			
Security 1,350M€			


Figura 15: Fondet për çdo Program të FP7

Siç u theksua dhe më sipër, në linkun e [CORDIS](http://cordis.europa.eu/fp7/home_en.html) do të gjeni një tabelë, të dedikuar fondeve, në të cilën përshihet programi “Kuadër 7, FP7” (http://cordis.europa.eu/fp7/home_en.html). Në pjesën në vazhdim do të përshkruhet faqja - web e këtij programi dhe më pas do të gjeni detajime për çdo nën-program specifik të këtij programi

Në faqen kryesore, të treguar në Figurën 16, do të gjeni informacion të përgjithshëm mbi këtë program. Në menynë në qendër të faqes, do të gjeni të listuara programet specifike të këtij programi, një panel me njoftimet më të reja si dhe një panel me aktivitetet që zhvillohen në kuadër të këtij programi.

Në menynë në të majtë, do të informoheni se çfarë është FP7, do të mund të futeni në [newsroom e FP7](#) ku do të gjeni njoftimet më të reja për ngjarjet, aktivitete të programit dhe intervista të ndryshme.

About CORDIS | Print | Legal Notice | Search | Contact | English (en)



CORDIS

Community Research and Development Information Service

European Commission > CORDIS > FP7

Home | News | Funding | Projects | Results | Partners | Go local
Share




Seventh Framework Programme (FP7)

[New Search \(beta\)](#) | [Map Search](#) | [Advanced Search](#)

Quick Links

- FP7 Home
- FP7 newswroom
- Understand FP7
- Participate in FP7
- Find a call (Participant Portal)
- Register your organisation
- Prepare and Submit Proposals (EPSS)
- Get support
- Find project partners
- Find a project
- Find a document
- Register as an Expert (EMM)



What type of user are you?

The Seventh Framework Programme (FP7) is designed to support a wide range of participants

- Private company
- Public organisation
- Individual researchers
- Outside the EU

Practical Guide to EU funding

Next Framework Programme: Horizon 2020

Previous Framework Programmes:



News highlights

[EU-funded prizewinning researchers deconstruct the internet!](#)
 [Date: 2012-02-01]
 The internet has become part of our everyday lives, in ways we would never have imagined 30 years ago, but how often do we pause and think about the how and why of getting online? A team of EU-funded Spanish researchers... [read more](#)

[» more news](#)

Forthcoming Events

- ['Confronting uncertainty in European labour markets in the crisis', Brussels, Belgium](#)
[Event date: 2012-02-15]
- ['Innovative Medicines Initiative open info day for the fifth IMI Call for Proposals', Brussels, Belgium](#)
[Event date: 2012-02-27]
- ['International symposium on stem cells and human liver disease, Paris, France](#)
[Event date: 2012-03-12]
- ['International human microbiome congress', Paris, France](#)
[Event date: 2012-03-19]
- ['Ninth International Cross-Disciplinary Conference on Web Accessibility, Lyon, France](#)
[Event date: 2012-04-16]
- ['11th Annual Workshop on the Economics of Information Security, Berlin, Germany](#)
[Event date: 2012-06-25]

[» more events](#)

Last updated on: 2012-02-12

OLAF

[To report suspected fraud involving money paid out by the EU](#)

Top | Sitemap | A-Z | Index | Glossary | FAQ | Help Desk | ©
CORDIS is managed by the Publications Office

Figura 16: Faqja Web e Programit FP7



Çfarë është FP7?

Informacion se çfarë është FP7 dhe programet specifike që ajo përmban ju mund t'i merrni duke klikuar në [Understand FP7](#).

Duke klikuar tek [Participate in FP7](#), do të merrni informacion kush ka të drejtë të marri pjesë në këtë program, kur mund të merrni pjesë në të, me çfarë projekti dhe si mund të merrni pjesë në këtë program.

Publikimi i Thirrjeve për Aplikim

Ju do të informoheni mbi thirrjet e hapura për aplikim në linkun [Find a call](#). Në këtë link publikohen të gjitha thirrjet për programet e FP7.

Ndihma dhe Suporti

“[Get support](#)” është faja që ju lidh me Pikat Kombëtare të Kontaktit, ku ju mund të drejtoheni për pyetje që mund të keni. Ne do të flasim në një pjesë të veçante për këto pika kontakti.

“[Find a document](#)” – Mund të gjeni dokumente të ndryshme që kanë lidhje me bazën ligjore mbi të cilën vepron ky program, rregulla të ndryshme, programe të punës, që nga viti 2007 deri në 2012, si dhe disa dokumente të tjera ndihmëse si: guida, manuale etj.

Partnerët

“[Find a project partners](#)” – është linku ku ju mund të gjeni partnerët, për të zhvilluar një projekt.

“Find a project” është një formë kërkimi që ju ndihmon të kërkonit projektet që janë zhvilluar në kuadër të këtij programi. Kjo është një bazë të dhënash shumë e pasur dhe interaktive. Nëpërmjet fushave të kërkimit, ju mund të gjeni projektin që lidhet me fushën tuaj të studimit.

Njoftime

“[FP7 newsroom](#)” është faja ku ju mund të informoheni rreth të gjithë njoftimeve dhe informacioneve të reja që publikohen në lidhje me këtë program dhe për programet specifike të tij.

Regjistrimi

“[Register your organization](#)” është linku ku ju mund të regjistroni organizatën tuaj.

“[Register as an Expert](#)” (EMM) është linku ku ju mund të regjistroni veten, si një ekspert. Gjithashtu aty do të gjeni dhe formën e logimit.

Në vazhdim do te jepet informacion mbi programet specifike të FP7.

COOPERATION PROGRAMME - PROGRAMI BASHKËPINIM	
Çfarë është?	Ky është një program i financuar nga Bashkimi Europian për bashkëpunimin në nivel Europian dhe ndërkombëtar të kërkuesve dhe akademikëve.
Objektivat	Objektivat e këtij programi janë mbështetja e aktiviteteve të kërkimit që organizohen nga kërkues që bashkëpunojnë me njeri-tjetrin në Europë, duke u bazuar mbi politikat e Bashkimit Europian.
Veprimet për marrjen e fondeve	<p>Programi Bashkëpunimi implementohet nëpërmjet thirrjeve për aplikim për tipet e mëposhtme të aktiviteteve:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Bashkëpunimi në kërkim: suporton projektet e kërkimit dhe rjetet e kërkuesve, nëpërmjet skemave të financimit të projekteve të Bashkëpunimit, Rrjetet e Ekselencës dhe veprimeve koordinuese, ose mbështetëse. ◆ JTI - Join Technology Initiatives - Iniciativat e Përbashkëta Teknologjike - janë partneritete publike dhe private me afate të bazuara në një nga temat e "Programit". Për të marrë mbështetje, një JTI duhet të ketë objektiva të qarta, të paraqesë një dimension të qartë europian dhe të jetë në gjendje të thithë investime dhe fonde nga bizneset dhe autoritetet qeveritare. ◆ Koordinimi i programeve të kërkimit nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> ○ ERA-NET - është një frame-work që mbështet pjesëmarrësit që vendosin një fond të përbashkët, i cili ndahet mbi bazën thirrjeve për propozime të përbashkëta. ○ Pjesëmarrja e komunitetit në programet kombëtare të kërkimit - është një iniciativë që asiston vendet anëtare të Bashkimit Europian në koordinimin e programeve të tyre të kërkimit. ◆ Bashkëpunimi ndërkombëtar: <ul style="list-style-type: none"> ○ Duke hapur të gjithë aktivitetet me një temë të caktuar për pjesëmarrësit nga rrethet e kërkuesve nga shtetet jo-anëtare të Bashkimit Europian, të cilat kanë marrëveshje me Bashkimin Europian në fushën e teknologjisë dhe kërkimit. ○ Veprime specifike për kooperime të bazuara mbi marrëveshje, midis Bashkimit Europian dhe vendeve jashtë Bashkimit Europian, si aksione për të rritur kapacitetet kërkuese në vendet candidate dhe fqinje dhe aksione që fokusohen në nevojat në shëndetësi, agrikulturë, peshkim dhe mjedis.
Si funksionon	Programi "Bashkëpunim" do të zhvillohen për të mbështetur kooperimin midis universiteteve, industrisë, qendrave të kërkimit dhe autoriteteve publike. Mbështetja i ofrohet një sërë aktiviteteve të kërkimit, të realizuara nga bashkëpunimi transnacional, nga projekte kolektive dhe rrjeteve të koordinimit të programeve të kërkimit. Bashkëpunimi ndërkombëtar midis Bashkimit Europian dhe vendeve të treta, është një pjesë shumë e rëndësishme e këtij programi.

Buxheti dhe Financimi	Buxheti total i programit “Bashkëpunim” është rreth 32,413 milion € për periudhën 7 - vjeçare 2007 – 2013. Fondet e bashkë-financimi: 75% për SME/akademitë/organe publike.
Kush ka të drejta?	Projektet mund të realizohen nga grupe kërkuesish individualisht në nivel kombëtar dhe universitete. Ky program inkurajon vazhdimisht pjesëmarrësit nga vendet jashtë Bashkimit Europian.
Thirrje për aplikim	Ky është linku ku do të gjeni të gjithë thirrjet e hapura për çdo temë të caktuar: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/fp7_calls?
Më shumë Informacion	http://cordis.europa.eu/fp7/cooperation/home_en.html#1

Tema : Health - Shëndetësi	
Objektivat	<p>Përmirësimi i shëndetit të qytetarëve, rritja e konkurrencës së sektorit të shëndetësisë në Europë si dhe trajtimi i rreziqeve globale në shëndetësi, ku përfshihen epidemitë. Gjithashtu vëmendje e veçantë i kushtohet aplikimit të rezultateve të kërkimit në praktikë, për të përmirësuar shërbimin shëndetësor. Prioritetet e këtij programi është aplikimi i teknologjive më të avancuara në projektet e SME-ve.</p> <p>Buxheti për këtë program është 6,100 milion € për periudhën 2007 - 2013</p>
Fusha e Kërkimeve	<p>Bio-teknologji, mjetet dhe teknologjitë e përgjithshme mjekësore për shëndetin e njeriut</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Kërkimi me rezultate të reja; ◆ Zbulimi, diagnostikimi dhe monitorimi; ◆ Parashikimi i përshtatshmërisë, sigurisë dhe eficiencës së terapive; ◆ Metodatat e reja të terapive dhe ndërhyrjeve kirurgjikale. <p>Zbatimi i kërkimeve në shëndetin e njeriut</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Integrimi i të dhënave dhe proceseve biologjike; ◆ Kërkime në sëmundjet e trurit dhe mendore, zhvillimin e njeriut dhe plakja; ◆ Kërkime për sëmundjet infektive si HIV/AIDS, malaria, tuberkulozi, SARS, gripi avian, etj; ◆ Kërkime në sëmundjet si: kanceri, sëmundjet kardiovaskulare, diabeti, obeziteti, sëmundjet e rralla, sëmundjet reumatoide, artritet dhe sëmundjet muskosletore. <p>Optimizimi i shërbimit shëndetësor në Europë</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Aplikimi i rezultateve kërkimore në praktikë; ◆ Cilësia, eficienta dhe solidariteti në sistemin e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë dhe sistemin tranzicional të kujdesit shëndetësor dhe strategjitë e kujdesit shëndetësor në shtëpi; ◆ Parandalimi i sëmundjeve dhe përdorimi më i mirë i medikamenteve; ◆ Përdorimi i duhur i terapive dhe teknologjive të reja shëndetësore.


Më shumë Informacion	Për më shumë informacion drejtohuni në linkun e Health FP7: http://cordis.europa.eu/fp7/health/home_en.html dhe për të marrë informacion rreth thirrjeve për aplikim drejtohuni linkut: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/cooperation
-----------------------------	---

Tema : Food, Agriculture and Biotechnology - Ushqim, Bujqësi dhe Peshkim, dhe Bioteknologji

Objektivat	Të ndërtohet një Europë me baza bio-ekonomike që të jetë në gjendje të shfrytëzojë rezultatet e kërkimeve, për të garantuar sigurinë në ushqime, qëndrueshmërinë e burimeve bio, agrikulturës dhe peshkimit, duke konsideruar ndryshimet klimaterike dhe mirëqenien e kafshëve.
Fusha e Kërkimeve	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Sigurimi i prodhimit dhe menaxhim të qëndrueshëm të burimeve biologjike të tokës, pyjet dhe ambientet ujore, duke siguruar kërkimin në sistemet e qëndrueshme të prodhimit, prodhimin dhe mirëqenien e bimëve dhe kafshëve, peshkimin dhe kulturën ujore, duke respektuar shfrytëzimin dhe përdorimin e kujdesshëm të bio-diversitetit të tyre. ◆ Mjetet për të implementuar strategjitë, politikat dhe legjisllacionin në përputhje me njohurit bio-ekonomike europiane. ◆ Integriteti dhe kontrolli i cilësisë së ushqimit, mund të jetë subjekt kërkimi shkencorë. ◆ Shkencat jetësore dhe bio-teknologjia për produkte të qëndrueshme jo-ushqimore për zhvillimin e burimeve të pyjeve, produkteve feed stock, produktet ujore dhe teknologjitë e biomasës për energjinë, mjedis, materiale dhe kimikate.
Më shumë Informacion	Për më shumë informacion drejtohuni në linkun e KBBE FP7: http://cordis.europa.eu/fp7/kbbe/home_en.html dhe për të marrë informacion rreth thirrjeve për aplikim drejtohuni linkut: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/cooperation

Tema : Information and Communication Technology (ICT) - Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)

Objektivat	Kjo është tema më e rëndësishme e politikave të Bashkimit Europian. Objektivi kryesor i kërkimit në TIK është rritja e konkurrencës së industrisë europiane duke u bërë lider në përhapjen dhe zhvillimin e këtyre teknologjive që kanë impakt të lartë në jetën ekonomike dhe sociale. Programi i Punës së FP7 ICT përcakton prioritetet dhe thirrjet për propozim.
Fusha e Kërkimeve	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Fushat shtyllë të TIK, si rrjetet e komunikimit ubiquitous dhe sistemet embedded; ◆ Integrimi i teknologjive, si në ambientet shtëpiake ose personale; ◆ Aplikimi i teknologjive TIK në fushën e mjekësisë, mjedis, lëvizshmërisë dhe në institucionet qeveritare; ◆ Aplikimi i teknologjive TIK në fushën e digjitalizimit të të dhënave, të mësimit dhe kulturës; ◆ Aplikimi i teknologjive TIK në biznes dhe industri; ◆ Përdorimi i teknologjive TIK për identifikim dhe autentifikimin; ◆ Në zhvillimin e teknologjive të reja.




Më shumë Informacion	<p>Për më shumë informacion drejtohuni në linket ICT të FP7: http://cordis.europa.eu/fp7/ict/ http://cordis.europa.eu/fp7/ict/programme/home_en.html dhe për të marrë informacion rreth thirrjeve për aplikim drejtohuni linket: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/cooperation http://cordis.europa.eu/fp7/ict/participating/calls_en.html</p>
-----------------------------	--

Tema: Nanosciences Nanotechnologies, Materials & new Production Technologies (NMP) - Nanoshkencë, Nanoteknologji, Materiale dhe Teknologjitë e Reja të Prodhimit

Objektivat	<p>Të transformojë industrinë aktuale në një industri të re dhe më të zhvilluar, duke zhvilluar dhe nxitur kërkimin për aplikimin të teknologjive nano dhe teknologjive të reja.</p> <p>Një objektiv tjetër është përforsimi dhe rritja e konkurrencës së industrisë europiane duke gjeneruar ndryshime të vazhdueshme në shumë sektorë të industrisë dhe aplikimi i njohurive për zhvillimin e aplikacioneve të reja, midis teknologjive dhe disiplinave të ndryshme.</p>
Fusha e Kërkimeve	<p>Nanoshkencë dhe Nanoteknologji: Objektivi është të krijohen materiale dhe sisteme me karakteristika të paracaktuara, duke u bazuar në njohuritë në shkallë - nano. Kjo do të çojë në një gjeneratë të re produktesh dhe shërbimesh me aplikim të gjerë, duke minimizuar impaktin negativ në mjedis dhe shëndetin e njeriut.</p> <p>Materialet: Kërkimi fokusohet në krijimin dhe zhvillimin e sipërfaqes multifunkionale të materialeve të reja, me karakteristika të përshtatshme dhe performancë të parashikueshme, për produktet e reja dhe proceset e rregullimit të tyre.</p> <p>Teknologjitë e reja: Inovacioni në këtë fushë mund të jenë zbulimi i njohurive e reja dhe zbatimi i tyre në prodhim dhe konsum. Kjo siguron kushtet e përshtatshme për të vazhduar novacioni në industri, sistemet e prodhimit, etj dhe për zhvillimin e përgjithshëm të prodhimit të “assets” (lehtësira në teknologji, organizim i burimeve njerëzore) duke respektuar sigurinë dhe nevojat e ambientit.</p> <p>Integrimi i teknologjive për aplikime industriale: Integrimi i njohurive dhe teknologjive të tri fushave të mësipërme të kërkimit është shumë i rëndësishëm, për të shpejtuar transformimin e industrisë dhe ekonomisë në Europë. Kërkimi fokusohet në aplikacione dhe zgjidhje të reja që lidhen me sfidat e mëdha si dhe nevojat e RTD-ve të identifikuar nga platforma të ndryshme teknologjike europiane.</p>
Më shumë Informacion	<p>Për më shumë informacion drejtohuni në linket ICT të FP7: http://cordis.europa.eu/fp7/cooperation/nanotechnology_en.html dhe për të marrë informacion rreth thirrjeve për aplikim drejtohuni linket: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/cooperation</p>

Tema : Energy – Energjia	
Objektivat	Për të zhvilluar energjinë elektrike në Europë, përmirësuar eficiencën e energjisë duke pasur parasysh sigurinë dhe ndryshimet klimaterike.
Fusha e Kërkimeve	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Aplikimi i qelizave të hidrogjenit dhe karburantit në transport; ◆ Prodhimi i energjisë elektrike të rinovueshme për të rritur eficiencën dhe reduktuar koston; ◆ Prodhimi i karburanteve me karbon neutral të rinovueshëm, veçanërisht i bio-karburanteve për transport; ◆ Energji e rinovueshme për ngrohje dhe ftohje; ◆ Teknologjitë e mbledhjes dhe ruajtjes së CO2; ◆ Teknologji të përparuara të qymyrit të pastër; ◆ Rrjete të zgjuara energjie si transformimi i rrjetit elektrik në rrjetet interaktive, midis prodhuesit dhe konsumatorit; ◆ Ruajtja dhe eficienta e energjisë në ndërtesa dhe industri; ◆ Politikat e energjisë.
Më shumë Informacion	Për më shumë informacion drejtohuni në linkun e Energjisë së FP7: http://cordis.europa.eu/fp7/energy/home_en.html dhe për të marrë informacion rreth thirrjeve për aplikim drejtohuni linket: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/cooperation

Tema : Environment – Ambient	
Objektivat	Të rritet qëndrueshmëria në menaxhimin e mjedisit, nëpërmjet kërkimit dhe bashkëveprimit midis biosferës, ekosistemit dhe aktiviteteve njerëzore. Zhvillimi i teknologjive të reja që zbatojnë këto njohuri. Theksi i vihet parashikimit të ndryshueshmërisë dhe ruajtjes.
Fusha e Kërkimeve	<p>Ndryshimet klimaterike, ndotja dhe rreziqet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Presionet në ambient dhe klimë; ◆ Mjedisi dhe shëndeti; ◆ Rreziqet natyrore. <p>Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Ruajtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe atyre të krijuara nga njeriu dhe ruajtja e biodiversitetit; ◆ Menaxhimi i mjedisit ujor. <p>Teknologjitë e mjedisit</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Teknologjitë ambientale për vëzhgimin, stimulimin, parandalimin, adaptimin, rregullimin dhe restaurimin e mjedisit natyral dhe atij të krijuar nga njeriu; ◆ Mbrotjtja, ruajtja dhe përmirësimi i trashëgimisë kulturore; ◆ Teknologjitë e vlerësimit, verifikimit dhe testimit. <p>Vrojtimi i Tokës dhe mjetet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Sistemet e vëzhgimit të Tokës dhe oqeanëve, metodat e monitorimit të ambientit dhe zhvillimin e mëtejshëm të tij; ◆ Metodatat e parashikimit të motit dhe mjetet e vlerësimit të zhvillimit të qëndrueshëm.



Më shumë Informacion	Për më shumë informacion drejtohuni në linkun e Energjisë së FP7: http://cordis.europa.eu/fp7/environment/home_en.html dhe për të marrë informacion rreth thirrjeve për aplikim drejtohuni linket: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/cooperation
-----------------------------	---


Tema : Transport – Transport	
Objektivat	Zhvillimi i sistemeve të integruara dhe ekologjike të transportit, duke respektuar ambientin dhe burimet natyrore dhe rritjen e konkurrencës së industrisë europiane.
Fusha e Kërkimeve	<ul style="list-style-type: none">◆ Aeronautikë dhe transporti ajror: transportit ajror ekologjik, rritja e eficiency së kohës koston, mbrojtja e avionëve dhe udhëtarëve, e ardhmja e transportit ajror;◆ Sipërfaqe transporti të qëndrueshme (hekurudhore, rrugore dhe ujore): sipërfaqe transporti ekologjike, inkurajimi i transportit model dhe dekurajimi i korridoreve të transporteve; sigurimi i lëvizshmërisë të qëndrueshme;◆ Zhvillimi dhe mbështetja e sistemit European Satelitor Galileo.
Më shumë Informacion	Për më shumë informacion drejtohuni në linkun e Energjisë së FP7: http://cordis.europa.eu/fp7/transport/home_en.html dhe për të marrë informacion rreth thirrjeve për aplikim drejtohuni linket: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/cooperation

Tema: Social-economic Science and The Humanities - Shkenca Social-ekonomike dhe Humanitare	
Objektivat	Përmirësimi i të kuptuarit të sfidave komplekse dhe të ndërlydhura social-ekonomike, si rritja ekonomike, punësimi dhe konkurrenca.
Fusha e Kërkimeve	<ul style="list-style-type: none">◆ Rritja ekonomike, punësimi dhe konkurrenca në një shoqëri në zhvillim (novacioni, politikat e konkurrencës dhe të tregut të punës, edukimi dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, strukturat ekonomike dhe të prodhimit)◆ Kombinimi i objektivave ekonomike, sociale dhe mjedisore në perspektivën Europiane (modelet social-ekonomike në Europë dhe në botë, kohezioni ekonomik dhe social midis rajoneve, dimensionet sociale dhe ekonomike të politikave mjedisore).◆ Tendencat kryesore në shoqëri dhe impakti i tyre (ndryshimet demografike, pajtimi i familjes me punën dhe shëndetësinë, me kualitetin e jetesës, politikat për të rinjtë, përjashtimet sociale dhe diskriminimi)◆ Europa në botë (tregtia, migrimi, varfëria, krimi, konfliktet dhe të drejtat, demokracia dhe përgjegjësitë, media, diversiteti kulturor dhe i trashëgimisë, besimet, veprimet dhe vlerat)◆ Indikatorët social-ekonomikë dhe shkencorë (përdorimi dhe vlerësimi i indikatorëve në politikëbërje në nivel mikro dhe makro)◆ Aktivitetet e së ardhmes (implikimi në të ardhmen i dijeve globale, migrimi, plakja, rreziku dhe fushata emergjente të kërkimit dhe shkencës)

Më shumë Informacion	Për më shumë informacion drejtohuni në linkun: http://cordis.europa.eu/fp7/ssh/home_en.html dhe për të marrë informacion rreth thirrjeve për aplikim drejtohuni linket: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/cooperation
-----------------------------	---

Tema : Security – Siguria	
Objektivat	Zhvillimi i njohurive dhe teknologjive për ndërtimin e mjeteve të nevojshme për garantimin e sigurisë së qytetarëve nga terrorizmi dhe krimet, në veçanti, duke stimuluar bashkëpunimin midis ofruesit dhe përdoruesve të mjeteve të sigurisë.
Fusha e Kërkimeve	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Rritja e sigurisë së qytetarëve - zgjidhjet teknologjike për mbrojtjen civile, bio-siguri, mbrojtja nga krimet dhe terrorizmi; ◆ Siguria e infrastrukturave dhe shërbimeve; ◆ Siguria kufitare: mjetet dhe pajisjet për përmirësimin e sigurisë së kufijve tokësor dhe atyre detarë; ◆ Rivendosja e sigurisë në raste krize; ◆ Siguria dhe shoqëria; ◆ Koordinimi i kërkimit të sigurisë dhe strukturimi i tyre.
Më shumë Informacion	Për më shumë informacion drejtohuni në: http://cordis.europa.eu/fp7/security/home_en.html dhe për të marrë informacion rreth thirrjeve për aplikim drejtohuni linket: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/cooperation Një pjesë e madhe e kësaj teme menaxhohet nga REA – Research Executive Agency dhe mund të gjeni informacion në linkun: http://ec.europa.eu/research/rea/


Tema : Space - Hapësirë	
Objektivat	Suport për European Space Programme - Programit Europian për Hapësirën dhe për konkurrencën në industrinë hapësinore Europiane. Gjithashtu zhvillimi i një politike europiane për Hapësirën.
Fusha e Kërkimeve	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Aplikacione hapësinore në shërbim të shoqërisë evropiane; ◆ Eksplorimi i Hapësirës; ◆ RTD për forcimin e themeleve hapësinore.
Më shumë Informacion	Për më shumë informacion drejtohuni në linkun: http://cordis.europa.eu/fp7/cooperation/space_en.html dhe për të marrë informacion rreth thirrjeve për aplikim drejtohuni linket: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/cooperation



IDEAS PROGRAMME - PROGRAMI IDETË	
Çfarë është?	Një program i financuar nga Bashkimi European për të mbështetur “kërkimin kufitar” të iniciuar nga kërkuesit. Ky është një program pasues i programit NEST të FP6 që mbështet kërkimin vizionar. Temat e projektit zgjidhen nga kërkuesit dhe gjykohen individualisht.
Objektivat	Objektivi kryesor i Programit Idetë është të përforcoje ekselencën Europiane në shkencë duke inkurajuar konkurrencën midis shteteve ose grupeve të kërkuesve në nivel European. Gjithashtu, ky program ka si objektivi, tërheqjen e investimeve të kërkimit European nga vendet jo anëtare të Bashkimit European. Komisioni ka si objektivi zhvillimin shkencor, progresin teknologjik dhe inkurajimin e kërkuesve të rinj për të qenë sa më aktiv në bashkëpunimet kërkimore.
Veprimet për marrjen e Fondeve	<p>Programi “Idetë” mbështet “kërkimin kufitar” të realizuar nga kërkues individualë, ose grupe kërkuesish. Ky program mbulon kërkimin në çdo fushë të shkencës dhe teknologjisë, si: fushat inxhinierike, shkencave social-ekonomike dhe humanitare.</p> <p>Grandet mbështesin projektet, të realizuara nga grupe kërkuesish individuale që kryesohen nga një kërkues kryesor i vetëm (P.I - principal investigatore). Këto grupe mund të përfshijnë grupe kombëtare, ose trans-kombëtare. Duhet theksuar që, instituti që ka si pjesëtarë P.I, do të marrë grandin, por me kushtin që, ky institucion, do të ofrojë kushte të përshtatshme për P.I që të punojë i pavarur dhe të menaxhojë fondet gjatë kohëzgjatjes së projektit.</p> <p>Institucioni duhet të sigurojë që P.I të mund:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Të aplikoj për financim të pavarur; ◆ Të menaxhojë kërkimin dhe financimin e projektit; ◆ Të publikojë botime si autor i parë dhe të shtojë në raport bashkë autorët, nëse ka; ◆ Supervizojë anëtarët e grupit, duke përfshirë studentët kërkues dhe studentët e doktoraturës.
Si funksionon	Ky program menaxhohet nga “European Research Council” - Keshilli European i Kërkimit - në formën e dy programeve të ndara: ERC Starting Independent Research Grants dhe The ERC Advanced Investigator Grants. Më poshtë, do të jepen detaje për këto dy programe. Në këto programe, partnerët nuk janë të nevojshëm.
Buxheti dhe Financimi	Buxheti për këtë program është 7,460 milion Euro për periudhën shtatë vjeçare. Normat e bashkëfinancimit ndryshojnë dhe mund t’i gjeni të listuara në tabelat individuale të këtyre programeve.
Kush ka të drejta?	Çdo organizatë, institucion që merret me kërkimin, mund të aplikojë në këtë program.
Thirrje për aplikim	Për të marrë informacion rreth thirrjeve për aplikim drejtojeni linkut: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/ideas Ofertat mund të dorëzohen në Europena Research Concile Executive Agency: http://erc.europa.eu/

Më shumë Informacion	Programin e punës mund ta gjeni në këtë link: ftp://ftp.cordis.europa.eu/pub/fp7/docs/wp/ideas/l-wp-200901_en_pdf.zip
-----------------------------	--

FP7 IDETË European Research Council Starting Grand-Grandi Fillestar i Këshillit Europian të Kërkimit	
Çfarë është?	Ky grand, financohet nga ERC nën programin FP7 Idetë. Ai është projektuar për t'i ardhur në ndihmë kërkuesve, të zhvillojnë dhe promovojnë aktivitetet e kërkimit, në Bashkimin Evropian.
Objektivat	Ky grand ka si qëllim të mbështesë kërkuesit (PI) në varësi të fushës së kërkimit, duke filluar nga momenti i krijimit të grupit të punës, ose që nga fillimi i programit individual të kërkimit. Ky grand mbështet krijimin e grupeve të reja, ose mbështete forcimin e grupeve, të cilat janë, tashmë, të krijuara.
Si funksionon	<p>Kërkuesi kryesor duhet të ketë potencial për kërkim të pavarur dhe eficient. Për shembull, duhet që aplikanti minimalisht, të ketë publikuar një punim pa pjesëmarrjen e eprorit me PhD.</p> <p>Propozimi duhet të përbëhet nga elementet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Potencial i drejtuesit shkencor shkencor: përshkrim i potencialit të drejtuesit shkencor të aplikuesit i cili duhet të përfshijë vetëvlerësimin e karrierës së mëparshme, duke treguar potencialin e aplikuesit, një prezantim me kontributin që aplikuesi ka dhënë dhe me njohjet dhe komentet nga profesionist të tjerë (çmime, citime, publikime). ◆ Curriculum Vitae: CV duhet të përfshijë të gjitha arritjet dhe kodin identifikues të fondeve "Funding ID" që specifikon fondet që aplikuesi mund të ketë përfituar dhe fushen e studimit. ◆ Arritjet që ka deri në momentin e aplikimit. ◆ Përshkrimi i propozimit: Një përshkrim shkencor konciz me aspekte teknike të projektit, duke demonstruar natyrën novatore të kërkimit, ndikimin e mundshëm dhe metodologjinë e kërkimit të përdorur. Gjithashtu, duhet të dokumentohen edhe detyrat e aplikantëve në këtë projekt. ◆ Mjedisi i Kërkimit: Një përshkrim i mjedisit ku do zhvillohen kërkimet, impakti dhe kontributi i tij në këtë projekt. <p>PI duhet të paraqesë një propozim në emër të institucionit që përfaqëson. Ky propozim, dorëzohet në mënyrë elektronike, nëpërmjet sistemit EPSS - Electronic Proposal Submission System. (Rekomandohet që të regjistrohesh në sistemin EPSS, përpara përfundimit të afatit të thirrjes)</p>
Buxheti dhe Financimi	Në varësi të projekteve dhe fushës, niveli i financimit të këtij grand, mund të jetë deri në rreth 2.000.000 € për një periudhë 5 -vjeçare.
Kush ka të drejta?	<p>Aplikantët mund të jenë nga çdo fushë kërkimore dhe të kenë çdo kombësi, por duhet të vendosin pse të ushtrojnë veprimtarinë e tyre kërkimore në një vend anëtar, ose vend të asociuar.</p> <p>PI duhet të ketë fituar titullin PhD, ose një diplomë ekuivalente doktrature, tre deri në tetë vjet, përpara datës së publikimit të thirrjes për propozim.</p>
Thirrje për aplikim	Informacion rreth thirrjeve për aplikim do të gjeni në linkun: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/ideas




Më shumë Informacion	Programin e Punës të botuar nga Këshilli Evropian i Kërkimit, do ta gjeni në linkun: ftp://ftp.cordis.europa.eu/pub/ftp7/docs/wp/ideas/l-wp-200901_en_pdf.zip
-----------------------------	--

FP7 IDETË European Research Council Advanced Grand-Grandi i Avancuar i Këshillit Evropian të Kërkimit	
Çfarë është?	Ky grand financohet nga ERC nën programin FP7 Idetë. Ai është projektuar për t'i ofruar një mundësi shkencëtarëve dhe studiuesve për të ndjekur studimet kufitare, e zgjedhur nga ata.
Objektivat	Ai synon të financojë ekipet individuale të udhëhequr nga PI ekzistues, ose të rinj. Ky projekt do të ndihmojë shkencëtarët e “diasporës” evropiane, apo ata me kombësi, jo nga vendet e BE, të japin kontributin e tyre në zhvillimin e kërkimit në Europë, për të vendosur veten e tyre në Evropë dhe të marrin përsipër rrezikun e lartë që sjellin drejtimit e reja në fushat e tyre apo në fusha të reja studimi.
Si funksionon	<p>Aplikantët për këtë grand, duhet të jenë kërkues aktivë dhe të kenë arritje të konsiderueshme në fushën e kërkimit dhjetë vitet e fundit, të cilat duhet të paraqiten në këtë aplikim.</p> <p>Propozimi duhet të përbëhet nga elementet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Potencial drejtuesit shkencor: përshkrim i potencialit të drejtuesit shkencor të aplikuesit, i cili duhet të përfshijë vetëvlerësimin e karrierës së mëparshme, duke treguar potencialin e aplikuesit, një prezantim me kontributin që aplikuesi ka dhënë, me njohjet dhe komentet nga profesionistë të tjerë (çmime, citime, publikime). ◆ Curriculum Vitae: CV duhet të përfshijë të gjitha arritjet dhe kodin identifikues të fondeve “Funding ID” që specifikon fondet që aplikuesi mund të ketë përfituar dhe fushën e studimit. ◆ Arritjet që ka deri në momentin e aplikimit. ◆ Përshkrimi i propozimit: Një përshkrim shkencor, konciz, me aspekte teknike të projektit, duke demonstruar natyrën novatore të kërkimit, ndikimin e mundshëm dhe metodologjinë e kërkimit të përdorur. Gjithashtu, duhet të dokumentohen edhe detyrat e aplikantëve, në këtë projekt. ◆ Mjedisi i Kërkimit: Një përshkrim i mjedisit ku do zhvillohen kërkimet, impakti dhe kontributi i tij në këtë projekt.
Buxheti dhe Financimi	<p>The ERC ka themeluar treguesit e mëposhtëm në përqindje për buxhetet e tri fushave kryesore të kërkimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Shkencat fizike dhe inxhinierike: 39%; ◆ Shkencat e jetës: 34%; ◆ Shkencat shoqërore dhe humanitare: 14%.
Kush ka të drejta?	Aplikantët mund të jenë nga çdo fushë kërkimore dhe të kenë kombësi të ndryshme, por duhet të vendosin pse të ushtrojnë veprimtarinë e tyre kërkimore, në një vend anëtar, ose vend të asociuar.
Thirrje për aplikim	Informacion rreth thirrjeve për aplikim do të gjeni në linkun: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/ideas

Më shumë Informacion	Programin e Punës të botuar nga Këshilli Evropian i Kërkimit do ta gjeni në linkun: ftp://ftp.cordis.europa.eu/pub/fp7/docs/wp/ideas/l-wp-200901_en.pdf.zip
-----------------------------	---

PEOPLE PROGRAME - PROGRAMI NJERËZIT	
Çfarë është?	Programi “Njerëzit” ka si qëllim të mbështesë trajnimin dhe zhvillimin e karrierës së studiuesve dhe të personave që kanë interes të bëjnë karrierë në kërkim. Propozimet e ndryshme mund të financohen përmes këtij programi nën atë që njihet si “Aksionet Marie Curie”.
Objektivat	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Të stimulohen njerëzit për të hyrë në profesionin e kërkimit. ◆ Të nxitin kërkuesit evropianë, të qëndrojnë në Europë. ◆ Të tërheqin kërkuesit nga pjesa tjetër e botës, të vijnë në Europë.
Veprimet për marrjen e Fondeve	<p>Më poshtë janë përmbledhur fushat e mundshme, ku mund të merren financime nga ky program.</p> <p>Trajnim fillestar për kërkuesit</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Këto aktivitete kanë për qëllim të përmirësojnë perspektivën e karrierës së kërkuesve evropian, si në sektorin publik dhe në atë privat, duke zgjeruar aftësitë e përgjithshme dhe ato shkencore të kërkuesve, nëpërmjet “Rrjetit të Kërkuesve të rinj - Marie Curie”. <p>Trajnimi gjatë gjithë jetës dhe zhvillimi i karrierës së kërkuesit.</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Ky aktivitet mbështet zhvillimin e karrierës dhe eksperiencës së kërkuesve. <p>Industria akademike, rrugët dhe partneriteti.</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Ky aktivitet do të mbështesë programet afatgjatë të bashkëpunimit midis rrjetit akademik dhe industrisë, sidomos me SME-të. <p>Dimension ndërkombëtar.</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Ky aktivitet ka për qëllim të tërheqë kërkues të talentuar nga vende jashtë Bashkimit Evropian dhe të nxisë bashkëpunimin reciprokisht të dobishëm, midis kërkuesve nga vendet e Bashkimit Evropian dhe kërkuesve në mbarë botën. <p>Veprime të tjera specifike.</p> <p>Mbështetja do të jetë në dispozicion për:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Mënjanimin e pengesave të lëvizshmërisë së kërkuesve, me qëllim për të krijuar një treg të vërtetë pune për kërkimin. ◆ Dhënia e çmimeve, shpërblimeve për të promovuar nxitjen e ndërgjegjes publike të Aksioneve “Marie Curie”.
Si funksionon	Kërkuesit dhe organizatat duhet t'i përgjigjen thirrjeve për propozime të këtij programi. Skema e financimit për programin “Njerëzit” është “Mbështetje për trajnimin dhe zhvillimin e karrierës së kërkuesve”.
Thirrje për aplikim	Informacion rreth thirrjeve për aplikim do të gjeni në linkun: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/people
Më shumë Informacion	Adresa e faqe web e Programit “Njerë” është: http://cordis.europa.eu/fp7/people/home_en.html



FP7: Njerëzit	
Marie Curie Initial Training Networks (ITN) - Rrjeti i Kërkuesve të Rinj “Marie Curie”	
Objektivat	Trajnimi fillestar i kërkuesve ofrohet përmes këtij aksioni me qëllim për të ndihmuar përmirësimin e aftësive kërkimore dhe plotësuese të kërkuesve, për të ndihmuar ata t'u bashkohen dhe të themelojnë ekipe kërkimore dhe për të rritur perspektivat e karrierës së tyre në sektorët publik dhe privat.
Veprimet për marrjen e Fondeve	Mbështetja sigurohet për: <ul style="list-style-type: none"> ◆ Rekrutimin e kërkuesve (në 5 vitet e para të karrierës së tyre) për trajnime fillestare; ◆ Rekrutimin e kërkuesve me përvojë në trajnimet dhe grupet e bashkëpunimit ndërkombëtar për të ndihmuar forcimin e transferimit të njohurive; ◆ Aktivitetet e Rrjetit, organizimi i seminareve dhe konferencave.
Si funksionon	Një pjesëmarrës (në këtë aksion një pjesëmarrës është një organizatë) duhet të jetë pjesë e një rrjeti, që ka të paktën 3 pjesëmarrës, nga tri vende të ndryshme që mund të jenë vende Anëtare, ose vende të Asociuara. Rrjetet do të zgjidhen nëpërmjet një konkursi, me dy faza vlerësimi. Propozimet vlerësohen nga ekspertët e jashtëm, të pavarur, kundër një sërë kriteresh dhe më pas, zgjidhen për financim për 4 vjet. Këto rrjete, duhet të propozojnë një program koherent.
Buxheti dhe Financimi	Kontributi financiar i Komunitetit mund të jetë deri në 100% në formë e granteve. Ky kontribut është llogaritur normalisht në bazë të së drejtës së pjesëmarrjes dhe mbi disa kushte specifike për çdo aksion.
Thirrje për aplikim	Informacion rreth thirrjeve për aplikim do të gjeni në linkun: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/people
Më shumë Informacion	Më shumë informacion mund të merrni në faqen web të “CORDIS” http://cordis.europa.eu/fp7/people/initial-training_en.html Programin e Punës mund ta gjeni në këtë link: http://cordis.europa.eu/fp7/wp_en.html#people

FP7: Njerëzit	
Marie Curie Intra-European Fellowships for Career Development (IEF) - Skema Inter Europiane për Zhvillimin e Karrierës Marie Curie	
Objektivat	Ky aksion synon të mbështesë kërkuesit në faza të ndryshme të karrierës së tyre, duke i ndihmuar ata të fitojnë eksperiencë të re dhe të zhvillojnë më tej aftësitë kërkimore.
Veprimet për marrjen e Fondeve	Kërkuesit nga vendet Anëtare, ose vendet e Asociuara që kanë diplomë doktorature, ose që kanë eksperiencë 4-vjeçare, me kohë të plotë, në fushën e kërkimit, pas përfundimit të një diplome tjetër. Mbështetja jepet për trajnime të avancuara (duke përfshirë aftësitë plotësuese) dhe lëvizshmërisë, e përkohshme në bazë të një “plani të zhvillimit të karrierës personale” i cili duhet të detajohet nga kërkuesi dhe personi që do ta mbikëqyrë atë, në organizatën ku do të shkoj.

Si funksionon	<p>Projekt- propozimet paraqiten në bashkëpunim me organizatën që do të presë kërkuesit dhe, më pas, ajo vlerësohet nga ekspertë të jashtëm të pavarur. Financimi sigurohet për një periudhë kohore prej 12-24 muaj.</p> <p>Ky veprim synon të mbështesë kërkuesit në realizimin dhe forcimin e pozicionit të tyre të pavarur, si profesorë, ose kërkues kryesorë në fushën e edukimit, apo biznesit.</p> <p>Projektet duhet të ndihmojnë në zhvillimin e karrierës së kërkuesve aktivë, më të mirë dhe më premtues, në Europë.</p>
Buxheti dhe Financimi	Financimi mbulon një rrogë për kërkuesin, si një kontribut në varësi të kostos së kërkimit, këto duhet të përcaktohen në projekt-propozim.
Thirrje për aplikim	<p>Informacion rreth thirrjeve për aplikim do të gjeni në linkun:</p> <p>http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/people</p>
Më shumë Informacion	<p>Më shumë informacion mund të merrni në faqen web të "CORDIS":</p> <p>http://cordis.europa.eu/fp7/people/life-long-training_en.html</p> <p>Programin e Punës mund ta gjeni në këtë link:</p> <p>http://cordis.europa.eu/fp7/wp_en.html#people</p>

FP7: Njerëzit Marie Curie European ReIntegration Grands (ERG) - Grandet Europiane për RiIntegrim Marie Curie	
Objektivat	Grandet europiane për Ri-Integrim "Marie Curie" kanë për qëllim të ofrojnë ndihmë financiare për kërkuesit që janë në kërkim të punësimit me kohëzgjatje të gjatë në fushën e kërkimit, pasi ata kanë përfunduar trajnimin e tyre në një nga Aksionet "Marie Curie".
Veprimet për marrjen e Fondeve	Ky Aksion, ndihmon në ri-integrimin e këtij kërkuesi në një organizatë kërkimesh, në një nga vendet Anëtare, ose vendet e Asociuara, duke përfshirë dhe vendin e shtetësisë së tij.
Si funksionon	<p>Një propozim duhet të përbëhet nga projekti kërkimor i cili do të realizohet nga institucioni pritës. Ky propozim duhet të dorëzohet një vit para përfundimit të Aksionit "Initial Marie Curie" që ka fituar kërkuesi dhe jo më shumë se 6 muaj pas përfundimit të tij.</p> <p>Marrëveshja e grandit do të nënshkruhet me institucionin pritës, i cili duhet angazhohet që t'i sigurojë kërkuesit mbështetjen e duhur dhe kontratën e punës me kohëzgjatje minimale, sa periudha e këtij propozimi.</p> <p>Kërkuesi që aplikon për këtë grand duhet të jetë me eksperiencë në kohën e paraqitjes së këtij propozimi, të ketë diplomë doktorature, ose të ketë eksperiencë pune prej 4-vitesh, në fushën e kërkimit dhe të kenë kombësi në një nga vendet Anëtare, ose vendet e Asociuara. Ata duhet të ketë përfutur më parë financim në një nga temat e financimit të FP6 / 7.</p>
Buxheti dhe Financimi	Grandi, mund mbulojë deri në 2/3 vjet, është kontribut fiks në varësi të kostos së pagesës së kërkuesit, ose kostos së kërkuesit, të lidhur me ri-integrimin e projektit të kërkimit në organizatën pritëse, ku përfshihen shpenzimet për rrogën e stafit ndihmës, shpenzimet e udhëtimeve dhe publikimeve. Një ndarje më të hollësishme të financimit, mund ta gjeni në programin e punës, në linkun e mëposhtëm. Shuma e grandit mund të jetë 15.000 € në vit, gjatë periudhës së ri-integrimit.

Thirrje për aplikim	Informacion rreth thirrjeve për aplikim do të gjeni në linkun: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/people
Më shumë Informacion	Më shumë informacion mund të merrni në faqen web të "CORDIS" http://cordis.europa.eu/fp7/people/life-long-training_en.html Programin e Punës mund ta gjeni në këtë link: http://cordis.europa.eu/fp7/wp_en.html#people

FP7: Njerëzit Marie Curie International Outgoing Fellowships for Career Development (IOF) - Skema Ndërkombëtare për të Lëvizur Jashtë Vendit Marie Curie	
Objektivat	Ky aksion synon t'i ofrojë kërkuesve europianë mundësinë për tu trajnuar dhe për të fituar njohuri të reja, në një nivel më të lartë kërkimor, në një organizatë të lartë kërkimi dhe, me pas, të kthehen në një organizatë në një nga shtetet Anëtarë, ose vendet e Asociuara.
Veprimet për marrjen e Fondeve	Nën këtë aksion, qëllimi kryesor është që të ofrojë trajnime dhe eksperiencë të reja në një vend të tretë në një organizatë kërkimore, të nivelit të lartë. Si rezultat i kësaj, kërkuesit do të kthehen me njohuri të reja, tek organizata e tyre pritëse. Kohëzgjatja e tij mund të jetë deri në tri vjet dhe është e detyrueshme për projektin që të përfshijë një program kërkimor koherent, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, në një fazë prej një –dy vjetësh. Më pas, duhet të kalohet në një vend të tretë, pas të cilit duhet të kemi një fazë ri-integrimi një-vjeçare në organizatën pritëse, në një nga vendet Anëtare, ose vendet e Asociuara.
Si funksionon	Propozimet paraqiten nga kërkuesi, në bashkëpunim me organizatën pritëse në një nga Shtetet Anëtarë, ose Vendet e Asociuara të cilat, më pas, vlerësohen nga ekspertë të jashtëm, të pavarur duke u bazuar në një sërë kriteresh të paracaktuara. Mbështetja financiare do të ofrohet për propozimet më të mira, për një periudhë deri në tri vjet. Ky aksion, synon të kontribuojë në hapa të rëndësishëm në karrierën e kërkuesve më të mirë, ndërkohë që ndihmon për zhvillimin e njohurive të komunitetit të kërkimit në BE, duke i fituar ato, nëpërmjet këtyre shkëmbimeve ndërkombëtare.
Buxheti dhe Financimi	Financimi sigurohet për trajnim të avancuar në bazë të "planit personal të zhvillimit të karrierës" të krijuar nga kërkuesi, nën mbikëqyrjen e supervisorit në organizatën pritëse. Financimi përfshin, në veçanti, një pagë për kërkuesin dhe një kontribut, në varësi të kostos së kërkimit. Kontributi financiar i Komunitetit, për veprimet indirekte, është në formën e një granti që mbulon, deri në 100% të buxhetit.
Më shumë Informacion	Më shumë informacion mund të merrni në faqen web të "CORDIS" http://cordis.europa.eu/fp7/people/international-dimension_en.html Programin e Punës mund ta gjeni në këtë link: http://cordis.europa.eu/fp7/wp_en.html#people

FP7: Njerëzit ‘Marie Curie International ReIntegration Grands (IRG) – Grandet Ndërkombëtare të Ri-Integrimit “Marie Curie”.	
Objektivat	Këto grande ndërkombëtare Ri-integrimi, sigurojnë ndihmë financiare për kërkuesit që dëshirojnë të kthehen dhe të gjejnë një punë në Europë, pasi ata kanë ka punuar në fushën e kërkimit, në një vend të tretë, për të paktën tri vjet. Kohëzgjatja e grandit është dy deri në katër vjet.
Veprimet për marrjen e fondeve	Ky aksion konsiston në mbështetjen financiare gjatë të paktën dy vjetëve, për projektet profesionale të ri-integrimit, në fushën kërkimore, në një organizatë pritëse, në një Shtet Anëtar, ose në një Vend të Asociuar. Projekti mund të përfshijë aktivitete kërkimore, trajnime, transferimin e njohurive, përdorim komercial, përhapjen dhe zhvillimin e bashkëpunimit me sektorin shkencor dhe / ose sektorin industrial të vendit të tretë, nga i cili studiuesi është kthyer.
Si funksionon	Projektet duhet të zhvillohen midis një kërkuesi që përmbush kriteret e mësipërme dhe një institucioni pritës. Projektet në këtë aksion pritet që të kontribuojnë në “qarkullimin e trurit” në nivel global dhe, në thelb, në përforcimin e potencialit njerëzor të kërkimit, në zonën europiane të kërkimit. Pritet që këto kërkues të sjellin me vete një rrjet të dobishëm bashkëpunimesh, për projekte të ardhshme ndërkombëtare kërkimore. Kthimi dhe ri-integrim bën që karriera e këtyre kërkuesve të zhvillohet në nivel europian dhe të rritet punësimi i tyre. Aplikimet vlerësohen dy herë në vit. Në qoftë se propozimi pranohet, komisioni nënshkruan një marrëveshje grand për ri-integrim me organizatën pritëse.
Buxheti dhe Financimi	Grandi do të mbulojë një periudhë prej dy -katër vjetësh dhe kjo është një normë kontributi për shpenzimet e pagave të kërkuesve dhe / ose të shpenzimeve që lidhen me projektin e kërkimit për ri-integrim, në institucionin pritës. Më shumë detaje do të gjeni në programin e punës, në linkun e mëposhtëm. Kontributi financiar i Komunitetit për veprimet indirekte është, në formën e një grandit që mbulon, deri në 100% te buxhetit.
Thirrje për aplikim	Informacion rreth thirrjeve për aplikim do të gjeni në linkun: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/people
Më shumë Informacion	Më shumë informacion mund të merrni në faqen web të ‘CORDIS’ http://cordis.europa.eu/fp7/people/life-long-training_en.html Programin e Punës mund ta gjeni në këtë link: http://cordis.europa.eu/fp7/wp_en.html#people

FP7: Njerëzit Marie Curie International Incoming Fellowships (IIF) – Skemat Ndërkombëtare për të Hyrë në Europë Marie Curie	
Objektivat	Qëllimi kryesor është të nxisë kërkuesit më të mirë, nga vendet e treta, të punojnë në projekte kërkimore në Europë, me qëllim për të zhvilluar bashkëpunime reciprokisht të dobishme, në fushën e kërkimit mes Europës dhe vendeve të treta.

Veprimet për marrjen e Fondeve	Aksioni siguron mbështetje financiare për projektet individuale të kërkimit, të paraqitura nga kërkues me eksperiencë, në bashkëpunim me një institucion pritës në BE ose në Vendet e Asociuara. Kërkuesi, në bashkëpunim me organizatën pritëse, duhet të zgjedhin temën e kërkimit. Kërkuesit do të përzgjidhen nga Komisioni, në bazë të propozimit të paraqitur, në bashkëpunim me organizatën pritëse.
Si funksionon	Propozimet paraqiten nga kërkuesi, në bashkëpunim me organizatën pritëse, në një nga Shtetet Anëtare, ose Vendet e Asociuara dhe vlerësohen nga ekspertë të jashtëm, të pavarur mbi bazën e disa kritereve të paracaktuara. Mbështetje financiare do të ofrohet për propozimet më të mira, për një periudhë deri në tri vjet.
Buxheti dhe Financimi	Financimi përfshin, në veçanti, një pagë për kërkuesin dhe një kontribut të lidhur me shpenzimet e kërkimit. Më shumë detaje do të gjeni në programin e punës, në linkun e mëposhtëm. Kontributi financiar i Komunitetit për veprimet indirekte është në formën e një grandi që mbulon, deri në 100% të buxhetit.
Thirrje për aplikim	Informacion rreth thirrjeve për aplikim do të gjeni në linkun: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/people
Më shumë Informacion	Më shumë informacion mund të merrni në faqen web të CORDIS: http://cordis.europa.eu/fp7/people/international-dimension_en.html Programin e Punës mund ta gjeni në këtë link: http://cordis.europa.eu/fp7/wp_en.html#people

FP7: Njerëzit Marie Curie Actions: International Research Staff Exchange Scheme (IRES) – Aksionet “Marie Curie” Skema e Shkëmbimit Ndërkombëtar të Stafit	
Objektivat	Ky është një aksion i ri, që synon forcimin e partneritetit të kërkimit, përmes shkëmbimit të stafit dhe aktiviteteve midis organizatave kërkimore europiane dhe organizatave nga vendet e tjera, mbi bazën e një marrëveshje në shkencë dhe teknologji dhe/ose vendeve që kanë politika fqinjësie.
Veprimet për marrjen e fondeve	Ofron mbështetje për organizatat kërkimore për të vendosur, ose për të përforcuar bashkëpunim afatgjatë në kërkim, përmes një programi të përbashkët për të shkëmbyer kërkues, për periudha të shkurtra. Në këtë rast, një pjesëmarrës është një organizatë kërkimore që do të krijojë një partneritet, të përbërë nga, të paktën, dy pjesëmarrës të tjerë me, të paktën, dy shtete të ndryshme, që mund të jenë Shtete Anëtare, ose Vendet të Asociuara dhe me një, ose më shumë organizata, të vendosura në një nga vendet që ka, ose është në procesin e nënshkrimit të një marrëveshje S & T.
Si funksionon	Pjesëmarrësit duhet të paraqesin propozime me kohëzgjatje disa vjeçare, pranë Komisionit për programe të përbashkëta, për shkëmbime të shkurtra të stafit kërkimor. Dhe stafi që merret me menaxhimin e propozimit mund të jetë pjesë e shkëmbimit. Stafi, i cili merr pjesë në shkëmbim, duhet të “komandohet”, në mënyrë që të garantojë ri-integrim të plotë dhe njohje pozitive të kësaj përvoje. Madhësia e programit të përbashkët dhe e partneritetit do të varet nga numri i kërkuesve, stafit teknik dhe menaxhues që do të marrin pjesë në shkëmbim.

Buxheti dhe Financimi	Kryesisht, çdo partner, duhet përkatësisht të financojë shpenzimet e lëvizjes së kërkuesve të tyre që largohen. Fondet në dispozicion nga BE-ja do të mbulojnë jetesën e kërkuesit evropian që po largohet (duke përfshirë shpenzimet e udhëtimit prej 1800€ për kërkues në muaj.
Thirrje për aplikim	Informacion rreth thirrjeve për aplikim do të gjeni në linkun: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/people
Më shumë Informacion	Më shumë informacion mund të merrni në faqen web të "CORDIS" http://cordis.europa.eu/fp7/people/international-dimension_en.html Programin e Punës mund ta gjeni në këtë link: http://cordis.europa.eu/fp7/wp_en.html#people

FP7: Njerëzit Marie Curie Industry-Academia Partnerships & Pathways (IAPP) – Partneriteti Industri-Akademi Marie Curie	
Objektivat	Partneritetet ndërmjet organizatave kërkimore publike dhe private, (duke përfshirë Universitetet, SME-të, dhe industrinë e prodhimit), bazuar në projekte kërkimore të përbashkëta, me qëllim rritjen e shkëmbimit të aftësive, midis dy sektorëve.
Veprimet për marrjen e Fondeve	Inkurajohen projektet në të gjitha fushat shkencore/teknologjike, të cilat kanë interes të veçantë nga BE-ja. Mbështetja do të sigurohet me kohëzgjatje nga dy muaj deri në dy vjet, nga aksionet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> ◆ Shkëmbimin e njohurive dhe përvojës, përmes stafit të organizatave pjesëmarrëse; ◆ Rekrutimin e studiuesve me përvojë nga jashtë partneritetit për t'i përfshirë në transferimin e njohurive dhe/ose trajnimin e kërkuesve; ◆ Aktivitete në rrjet, organizimin e seminareve dhe konferencave, duke përfshirë personelin kërkimor dhe kërkues të jashtëm.
Si funksionon	Stafi shkëmbyes mund të jetë në nivel fillestar, ose me eksperiencë të gjatë në fushën e kërkimit, gjithashtu në shkëmbim, mund të përfshihet edhe stafi teknik dhe ai që merret me menaxhimin e shkëmbimit. Si pjesë e kriterëve të kualifikimit, anëtarët e stafit të një institucioni pjesëmarrës, duhet kenë qenë aktiv vazhdimisht, për të paktën një vit në këtë institucion. Nuk ka një numër specifik të partnerëve të nevojshëm për këtë aksion.
Buxheti dhe Financimi	BE-ja mund të mbështesë këtë veprim përmes një sërë mënyrash: <ul style="list-style-type: none"> ◆ Kosto të lidhura me drejtimin e stafit të dy sektorëve, në kuadër të partneritetit; ◆ Shpenzimet e lidhura me pritjen e përkohshme të kërkuesve me eksperiencë, të rekrutuar jashtë partneritetit; ◆ Shpenzimet e rrjetit, organizimi i seminareve dhe konferencave; ◆ Kontribut në kostot e SME-ve, nëse ajo është pjesë aktive e projektit.
Thirrje për aplikim	Informacion rreth thirrjeve për aplikim do të gjeni në linkun: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/people

Më shumë Informacion	Më shumë informacion mund të merrni në faqen web të “CORDIS”: http://cordis.europa.eu/fp7/people/industry-academia_en.html Programin e Punës mund ta gjeni në këtë link: http://cordis.europa.eu/fp7/wp_en.html#people
-----------------------------	--

FP7: Njerëzit Researchers' Night - Netët e Kërkuesve	
Objektivat	“Netët e Kërkuesve” organizohen, kryesisht, për të kontribuar në sjelljen, më afër me njëri-tjetrin, kërkuesit me publikun. Këto netë, zhvillohen në të premtën e 4-të të shtatorit dhe mundësojnë që njerëzit e thjeshtë, të kenë kontakt të drejtpërdrejtë me kërkuesit, nëpërmjet aktiviteteve të tilla si: eksperimente, demonstrime shkencore dhe animacione, në një atmosferë relaksuese.
Si funksionon	Propozimet për aktivitetet duhet të dorëzohen në afatet e caktuara dhe vlerësohen nga ekspertët e jashtëm. Çdo person juridik, nga një Shtet Anëtar, ose Vend i Asociuar, ka të drejtë të mobilizojë komunitetin kombëtar/rajonat të kërkuesve, për të organizuar ngjarje të cilat mund të mobilizojnë një pjesë të madhe të audiencës, duke mbledhur të gjitha grupet e popullsisë.
Buxheti dhe Financimi	Brenda kufijve të buxhetit në dispozicion, financimi ka mundësi për të mbuluar, për një periudhë deri në 7 muaj, të gjitha shpenzimet, lidhur me organizimin e aktiviteteve, duke filluar që nga veprimet përgatitore (për shembull, një fushatë ndërgjegjësimi) e deri tek masat që duhen për vlerësimin e ndikimit në audiencë.
Thirrje për aplikim	Informacion rreth thirrjeve për aplikim do të gjeni në linkun: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/people
Më shumë Informacion	Më shumë informacion mund të merrni në faqen web të “CORDIS” http://cordis.europa.eu/fp7/people/specific-actions_en.html Programin e Punës mund ta gjeni në këtë link: http://cordis.europa.eu/fp7/wp_en.html#people

CAPACITIES PROGRAMME - PROGRAMI KAPACITETET	
Çfarë është?	Një program financimi i BE-së, për të mbështetur zgjerimin dhe përdorimin optimal të infrastrukturës europiane, e cila mbështet kërkimin dhe zhvillimin në të gjithë fushat e shkencës dhe teknologjisë.
Objektivat	Programi “Kapacitetet” synon t’i sigurojë komunitetit europian të shkencës, kapacitetet më të mira, të mundshme për kërkime. Për të përmbushur këtë, programi ka për qëllim të: <ul style="list-style-type: none"> ◆ Mbështesë zhvillimin koherent të politikave; ◆ Të përfundojë programin e “bashkëpunimit” të FP7; ◆ Të japë kontribut në politikat dhe nismat e BE-së, për të përmirësuar koherencën dhe ndikimin e politikave të Shteteve Anëtarë.
Veprimet për marrjen e Fondeve	Programi ndahet në fushat e mëposhtme, të cilat shpjegohen, më hollësisht, në pjesën në vazhdim: <ol style="list-style-type: none"> 1. Infrastruktura kërkimore; 2. Kërkime në dobi të SME-ve; 3. Rajonet e Dijes; 4. Potenciali i kërkimit dhe Rajonet e Konvergencës; 5. Shkenca në shoqëri; 6. Mbështetja e zhvillimit të politikave të kërkimit; 7. Bashkëpunim ndërkombëtar.

Si funksionon	Pjesa më e madhe e aktiviteteve zbatohen nga thirrjet për “Aksionet për Bashkëpunim dhe Mbështetje” të FP7.
Buxheti dhe Financimi	4.291 milionë euro do të jepet për një periudhë prej shtatë vjetësh. Një ndarje e detajuar, është në dispozicion në linkun e mëposhtëm.
Thirrje për aplikim	Informacion rreth thirrjeve për aplikim do të gjeni në linkun: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/capacities
Më shumë Informacion	Informacion mbi buxheti do të gjeni në linkun: http://cordis.europa.eu/fp7/budget_en.html Faqja web e këtij programi është: http://cordis.europa.eu/fp7/capacities/home_en.html

Tema 1: Research Infrastructure – Infrastruktura e Kërkimit

Objektivat	Për të qenë optimist në përdorimin dhe zhvillimin e infrastrukturës kërkimore, në përputhje me vizionin për kërkesat e kërkimit afat- mesëm dhe afat- gjatë të ESFRI (European Strategy Forum on Research Infrastructure).
Fusha e Kërkimeve	<p>Mbështetje për infrastrukturat kërkimore ekzistuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Aktivitete Integrimi - duke siguruar një akses më të gjerë dhe më të efektshëm, në përdorimin e infrastrukturave kërkimore që ekzistojnë në Shtetet Anëtare të BE-së, Vendet e Asociuara dhe në nivel ndërkombëtar; ◆ E-Infrastruktura baze TIK - mbështesin një numër të ndërlidhur temash, të projektuara për të nxitur krijimin e një mjedisi kërkuesish të rinj, në të cilin ‘komunitetet virtuale’ ndajnë dhe shfrytëzojnë fuqinë kolektive të objekteve shkencore dhe inxhinierike europiane. <p>Mbështetja e infrastrukturave të reja kërkimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Studime Dizajni - koncepte për infrastruktura të reja kërkimi, me dimensione europiane dhe interesa të qarta. Ndërtimi i infrastrukturave të reja - sigurimi i mbështetjes për fazën përgatitore të ndërtimit të infrastrukturave të reja kërkimore. <p>Masat përcjellëse</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Zhvillimin e politikave - mbështetja në kuadër të ndërtimit të një Zone Europiane të Kërkimit, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, bashkërendimin e politikave kombëtare dhe / ose rajonale dhe programet në fushën e infrastrukturës kërkimore. ◆ Zbatimin e programit dhe mbështetje për nevojat e reja - mbështetjen e zbatimit efektiv të këtij programi, duke nxitur bashkëpunimin midis Pikave Kombëtare të Kontaktit (NCPs) dhe duke nxitur masat për identifikimin e nevojave emergjente.
Vlerësimi	Kriteret e përzgjedhjes kanë parasysh pikat e mëposhtme: -Vlera e përkrahjes së BE-së, kapacitetet për të ofruar shërbim për Komunitetin European Shkencor, rëndësinë ndërkombëtare, fizibilitetin, potencialin për partneritetin europian, shpenzimet.
Thirrje për aplikim	Informacion rreth kësaj teme do të gjeni në linkun: http://cordis.europa.eu/fp7/capacities/research-infrastructures_en.html

Tema 2: Research for the Benefit of SME – Kërkimi në Shërbim të SME - ve

Objektivat	<p>Të forcohet risia në SME dhe rritja e rolit të tyre në zhvillimin e produkteve teknologjike të reja. Shtetet Anëtare të BE-së kanë një total prej 1.336 milion euro për të financuar dhe mbështetur kërkimin e SME-ve, gjatë kohëzgjatjes së FP7.</p>
Fusha e Kërkimeve	<p>1. Përkrahja e aktiviteteve të kërkimit të SME-ve Kjo mbështetje ka për qëllim mbështetjen e SME-ve, apo shoqatave të SME-ve që kanë nevojë për burime të jashtme kërkimore.</p> <p>Kjo realizohet përmes dy skemave të ndryshme: <i>Kërkimi për SME-të</i> – ka si synim SME-të me teknologji të ulët në mesatare pa, ose me pak aftësi kërkimi, por gjithashtu dhe SME-të me teknologji të lartë, të cilat kanë nevojë për burime të jashtme kërkuesish, për të plotësuar aftësinë e tyre kërkimore. Projektet kanë si synim të krijojnë njohuri të reja, ose rezultate prodhimi me potencial të qartë, për të përmirësuar, apo zhvilluar produkte, procese ose shërbime të reja për SME-të pjesëmarrëse. <i>Kërkimi për shoqatat e SME-ve</i> – ka si synim shoqatat, të cilat veprojnë në emër të anëtarëve të SME-ve të tyre, për të identifikuar dhe adresuar problemet e përbashkëta teknike dhe të promovojnë shpërndarjen efektive dhe marrjen e rezultateve. Projektet në këtë aktivitet mund të adresojnë tema të tilla si: çështje para-normative të kërkimit, problemet teknike të lidhura me zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe problemet teknologjike të të gjithë sektorit industrial.</p> <p>2. Zhvillimin dhe koordinimin e mbështetjes të SME-ve në nivel kombëtar Në perspektivë afatgjatë, pritet që programet kombëtare dhe rajonale të kërkimit për SME-të, të kenë objektiva dhe metoda vlerësimi të përbashkëta për bashkëpunimin trans-nacional kërkimor me mbështetje të Komunitetit, për të mirën e SME-ve. Mbështetja financiare bazohet në “Article 159 initiatives”; Mbështetje financiare për skemat kombëtare të sigurimit të mjeteve financiare për SME-të, ose shoqatat e SME-ve për të përgatitur propozimet. Projekti “ERA-NET” ka si qëllim bashkërendimin e programeve kombëtare dhe rajonale që merren me SME-të, në mënyrë të ngjashme si “Kërkime për SME-të” dhe “Kërkime për shoqatat e SME-ve;</p> <p>3. Masat mbështetëse Në këtë kontekst, do të ndërmerren masat për të përforcuar ndikimin e pjesëmarrjes në projektet specifike të kërkimit të SME-ve dhe monitorimin e pjesëmarrjes në FP7. Aksionet e bashkërendimit dhe mbështetjes, do të akordohen për projektet që favorizojnë dhe rrisin ndikimin e veprimeve të ndërmarra nën ‘Kërkime në dobi të SME-ve’. Studimet mund të ndërmerren në faza të ndryshme të FP7 për të analizuar dhe vlerësuar ndikimin socio-ekonomik, në nevojat e pjesëmarrësve në “Kërkime në dobi të SME-ve”.</p>
Më shumë Informacion	<p>Ju mund të merrni më shumë informacion mbi këtë temë në linkun: http://cordis.europa.eu/fp7/capacities/research-sme_en.html</p>

Tema 3: Regions of Knowledge – Rajonet e Dijes	
Objektivat	Forcimi i potencialit të kërkimit në rajonet europiane, në veçanti duke mbështetur grupimet e universiteteve, autorët rajonalë dhe ndërmarrjet e përfshira në kërkim. Për këtë aksion, financimi total në dispozicion për periudhën 7-vjeçare, është 126 milion euro.
Fusha e Kërkimeve	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Analizimin, zhvillimin dhe implementimin e agjendave kërkimore për zona rajonale, ose ndër-kufitare. ◆ Udhëzimet e rajoneve me një profil më pak të zhvilluar kërkimor, në një profil të zhvilluar. ◆ Iniciativa për të përmirësuar integrimin.
Më shumë Informacion	Ju mund të merrni me shumë informacion mbi këtë temë në linkun: http://cordis.europa.eu/fp7/capacities/regions-knowledge_en.html

Tema 4: Research Potential - Potenciali i Kërkimit	
Objektivat	Të krijohen potenciale kërkimi në rajonet e konvergencës dhe të jashtme.
Fusha e Kërkimeve	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Seminare dhe konferenca të krijuara, për të lehtësuar transferimin e njohurive. ◆ Shpërndarja dhe transferimi i rezultateve kërkimore europiane, në vendet jo anëtare të BE-së.

Tema 5: Science in Society – Shkenca në Shoqëri	
Objektivat	Për të nxitur ndërveprimin aktiv, ndërmjet shkencëtarëve dhe publikut. Me këtë temë, Bashkimi Europian synon të krijojë një shoqëri me baza efektive dhe demokratike njohurish. Buxheti i përgjithshëm, për shtatë vjet, në këtë temë është 330 milion euro.
Fusha e Kërkimeve	<ol style="list-style-type: none"> 1. Qeverisje më dinamike të marrëdhënieve mes shkencës dhe shoqërisë: <ul style="list-style-type: none"> ○ Kërkimi mbi etikën në shkencë dhe teknologji; ○ Ndikimi reciprok i shkencës dhe kulturës; ○ Kushte për një debat informues mbi etikën dhe shkencën. 2. Forcimi i potencialeve, zgjerimi i horizontit: <ul style="list-style-type: none"> ○ Forcimi i rolit të gruas në kërkimin shkencor; ○ Mbështetja e arsimit shkencor formal dhe joformal në edukim; ○ Përforcimi i lidhjeve midis edukimit shkencor dhe karrierës shkencore. 3. Komunikimi shkencë dhe shoqëri: <ul style="list-style-type: none"> ○ Inkurajimi i një dimensionit europian në ngjarje shkencore, duke pasur parasysh publikun; ○ Shpërblimet e shkencës; 4. Bashkëpunimi ndër-nacional midis Pikave Kombëtare të Kontaktit (NCPs) për “Shkencë në shoqëri”
Më shumë Informacion	Ju mund të merrni me shumë informacion mbi këtë temë në linkun: http://cordis.europa.eu/fp7/sis/home_en.html

Tema 6: International Cooperation - Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Objektivat	<p>BE të luaj një rol udhëheqës në mbarë botën kërkimore. Kjo do të mund të realizohet duke përhapur zhvillimin shkencor dhe teknologjik me vendet e treta dhe forcimin e lidhjeve me institutet kërkimore ndërkombëtare.</p>
Fusha e Kërkimeve	<p>Veprimet ndërkombëtare në fushën e potencialit njerëzor janë nën programin “Njerëzit”.</p> <p>Programi “Kapacitete” do të implementojë veprimet horizontale mbështetëse dhe masa të fokusuara në tematika specifike dhe zona ndërdisiplinore. Ky program, gjithashtu synon të mbështesë koordinimin e programeve kombëtare për bashkëpunim ndërkombëtar shkencor dhe veprime të ndryshme bashkëpunimi ndërkombëtar, nën programe të ndryshme të FP7. Iniciativat në këtë program do të përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Koordinim bi-rajonat të bashkëpunimit S&T duke përfshirë përcaktimin e prioriteteve dhe përkufizimin e politikave të bashkëpunimit të S & T, duke sjellë, së bashku, krijuesit e politikave, komunitetin shkencor, shoqërinë civile dhe aktorë të sektorit privat nga BE dhe vende të treta, për të identifikuar prioritetet dhe për të përcaktuar orientimin e politikave; ◆ Koordinimin dypalësh për rritjen dhe zhvillimin e partneritet të S&T. <ul style="list-style-type: none"> ○ Përmirësimi i ofrimit të informacionit mbi programet dhe financimin, për të promovuar dhe nxitur bashkëpunimin midis Europës dhe vendeve të treta të caktuara, ○ Identifikimin dhe demonstrimin, më të mirë të interesave dhe përfitimeve të përbashkëta, në bashkëpunimet S&T, midis vendeve të BE-në dhe vendeve të treta të caktuara. ○ Ndarjen e praktikave më të mira, nëpërmjet forumeve të përbashkëta si: seminare dhe prezantimi i situatës dhe perspektivës së bashkëpunimit, në fusha të caktuara. ◆ Mbështetje për politikën dhe aktivitetet ndërkombëtare të koordinimit, në bashkëpunimin internacional S&T të Shteteve Anëtare dhe Vendeve të Asociuara. Objektivi i skemës “ERA-NET” është të vendosë bashkëpunimin dhe koordinimin e programeve nacionale dhe regjionale të kërkimit, nëpërmjet rrjeteve duke synuar aksesin e ndërsjellë, zhvillimin dhe implementimin e aktiviteteve të përbashkëta. <ul style="list-style-type: none"> ○ Bashkëpunimi ndërkombëtar ERA-NET ○ Bashkëpunimi ndërkombëtar ERA-NET PLUS
Më shumë Informacion	<p>Ju mund të merrni me shumë informacion mbi këtë temë në linkun: http://cordis.europa.eu/fp7/capacities/international-cooperation_en.html</p>

8

Marie Curie Actions - Aksionet Marie Curie

“Marie Curie Actions” u përshkrua në kapitullin paraardhës. Këtu do të njihemi me faqen zyrtare të “Marie Curie” dhe me faqe të tjera, të cilat publikojnë informacion mbi Aksionet “Marie Curie”. Faqja zyrtare e Aksioneve “Marie Curie” është : <http://ec.europa.eu/research/mariecurieactions/>. Faqe të tjera, ku ju mund të gjeni informacion mbi këtë projekt është dhe faqja e “CORDIS” në linkun: http://cordis.europa.eu/fp7/mariecurieactions/home_en.html dhe faqja http://ec.europa.eu/research/fp7/understanding/marie-curieinbrief/home_en.html

Në Figurën 17 tregohet faqja zyrtare e Aksioneve “Marie Curie”. Kjo faqe është e ndarë në tri zona: Financimi, Karriera dhe Politikat.

European Commission
Research & Innovation

European Commission > Research > Marie Curie Actions

Welcome to the Marie Curie Actions

Career Opportunities for Researchers
anytime - anyplace - anywhere

Careers

- Job vacancies
- Publish a job vacancy
- Taking control of your career

Funding

- WHAT are the Marie Curie Actions
- WHICH actions are suited for me
- HOW to apply
- WHEN to apply
- WHERE is my application
- HOW TO manage my project
- HELP? Your questions answered

Publications

- EURAXESS - Researchers in motion
- European policies for researchers
- The European Charter 4 Researchers and the Code of Conduct 4 their Recruitment
- Europe4Researchers Newsletter

Events

Figura 17: Faqja Web e Marie Curie Actions



Financimi në Aksionet “Marie Curie”

Në këtë pjesë ju do të merrni informacion të detajuar mbi, çfarë janë “Aksionet Marie Curie”, mënyrën e aplikimit, mënyrën e menaxhimit të projektit tuaj dhe mbi mënyrat e kontaktit.

Çfarë janë “Aksionet Marie Curie”? ([What are the Marie Curie Actions](http://ec.europa.eu/research/fp7/understanding/marie-curieinbrief/home_en.html)) - http://ec.europa.eu/research/fp7/understanding/marie-curieinbrief/home_en.html

- është një link ky mund të gjeni informacione se çfarë janë “Aksionet Marie Curie” dhe përshkrimin e tipave të tyre.

Cilat Aksione janë më të përshtatshme për mua? ([Which actions are suited for me](http://cordis.europa.eu/fp7/mariecurieactions/guide_en.html)) - http://cordis.europa.eu/fp7/mariecurieactions/guide_en.html - një link i jashtëm ku ju mund të gjeni një guidë për “Aksionet Marie Curie”.


Si të aplikojmë? ([How to apply](http://ec.europa.eu/research/mariecurieactions/how.htm)) - <http://ec.europa.eu/research/mariecurieactions/how.htm> - Në këtë faqe jepen informacionet e nevojshme për mënyrën e aplikimit. Në të djathtë të faqes, do të gjeni të listuara të gjitha “Aksionet Marie Curie”, duke klikuar mbi to, mund të merrni të gjithë informacionin e nevojshëm për mënyrën e aplikimit.

Ku të aplikojmë? ([When to apply?](http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/people&state=open)) - <http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/people&state=open> - ky është linku që ju drejton në portalin e thirrjeve për aplikim. Në të do të gjeni të gjithë thirrjet për aplikim të hapura. Gjithashtu do të mund të njiheni dhe me thirrjet për aplikim që janë mbyllur.

Ku është aplikimi im? ([Where is my application](http://ec.europa.eu/research/mariecurieactions/where.htm))

- <http://ec.europa.eu/research/mariecurieactions/where.htm> - ky link ju drejton në një faqe të ngjashme me atë të “Si të aplikojmë?” dhe duke zgjedhur një nga Aksionet në të djathtë të faqes, do të gjeni informacion mbi vendin e ruajtjes së aplikimeve.

Si të menaxhoni projektin tuaj ? ([How to manage my project](http://ec.europa.eu/research/mariecurieactions/manage.htm)) - <http://ec.europa.eu/research/mariecurieactions/manage.htm> - edhe ky link është i ngjashëm me atë që përshkruam pak më sipër. Duke klikuar në një nga Aksionet e listuara, në të majtë të faqes, do t’ju hapet një faqe, ku mund të merrni të gjithë informacionin e nevojshëm, për mënyrën e menaxhimit të projektit.



Ndihma: “Përgjigja e pyetjeve tuaja” - [Help? Your questions answered - http://cordis.europa.eu/fp7/mariecurieactions/get-support_en.html](http://cordis.europa.eu/fp7/mariecurieactions/get-support_en.html) - është linku i suportit, ku ju mund të gjeni përgjigje për çdo pyetje që mund të keni mbi Aksionet Marie Curie.

Careers - Karriera

Kjo pjesë e faqes i dedikohet karrierës dhe do të merrni informacion rreth çështjeve të mëposhtme:

Vende vakante të punës - <http://ec.europa.eu/euraxess/index.cfm/jobs/jvSearch> - është një link që ju lidh me EURAXESS që është platforma e Komunitetit European për publikimin e vendeve vakante të punës, në të gjithë shtetet anëtare të kësaj platforme.

Publikimi i një vendi vakant pune - http://ec.europa.eu/research/mariecurieactions/publish_en.htm - është një guidë për hapat që duhet të ndiqni për të publikuar një vend vakant pune.

Karriera - http://ec.europa.eu/research/mariecurieactions/careers_en.htm - është një link ku do të gjeni materiale që do ju ndihmojnë në përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të karrierës tuaj.

Politikat

Në këtë pjesë te faqes do të gjeni politika të Kërkimit Shkencor në Europë dhe janë linke në faqet e platformës EURAXESS.

Euraxess - Researchers in motion - <http://ec.europa.eu/euraxess/index.cfm/general/index> - linku i EURAXESS dhe tri nën pikat e kësaj pjese, lidhen me politikat e kërkimit European, Kodi European i Kërkimit dhe publikimet që lidhen me kërkimin.

Are You Marie Curious? - <http://ec.europa.eu/research/mariecurieactions/mariecurious/index.htm> - kjo zone është për kërkuesit e rinj, në atë zonë mund të gjeni informacionet e nevojshme për nisjen e karrierës së kërkuesve të rinj si, kërkues profesional dhe oportunitetet që i ofrohen.

Publikimet - <http://ec.europa.eu/research/mariecurieactions/publications.htm> - këtu mund të gjeni publikimet që lidhen me Aksionet Marie Curie

Ngjarjet - <http://ec.europa.eu/research/mariecurieactions/events.cfm> - këtu do të gjeni të gjithë aktivitetet dhe ngjarjet që organizohen në lidhje me këto Aksione, si dhe informacione mbi eventet e kaluara.

Siç e përmendëm dhe më lart, “Aksionet Marie Curie” kanë faqen e tyre në “CORDIS” http://cordis.europa.eu/fp7/mariecurieactions/home_en.html. Kjo faqe është e ndarë në tri fusha kryesore. Në fushën në qendër të faqes, tregohen “Aksionet Marie Curie”, duke klikuar në secilën prej tyre, do të merrni informacion për to.

The screenshot shows the Marie Curie Actions website interface. At the top, there's a navigation bar with 'CORDIS Community Research and Development Information Service' and 'European Commission'. Below this is a search bar and a 'Marie Curie Actions' logo. The main content area is divided into several sections:

- Initial training:** Includes 'Initial Training Networks' with a portrait of a woman.
- International dimension:** Includes 'International Outgoing Fellowships for career development', 'International Incoming Fellowships', and 'International Research Staff Exchange Scheme' with a portrait of a man.
- Life-long training:** Includes 'Intra-European Fellowships for career development', 'Career Integration Grants', 'European Reintegration Grants', and 'International Reintegration Grants' with a portrait of a man.
- Industry - Academia:** Includes 'Industry-Academia Partnerships and Pathways' with a portrait of a man.

On the right side, there's a 'Highlights' section with dates like '21 July 2009' and '06 May 2009', and a portrait of Marie Curie. At the bottom, there's a footer with 'Last updated on: 2010-11-03' and 'CORDIS is managed by the Publications Office'.

Figura 18: Faqja Web Cordis-Marie Curie Actions



Menyja në të majtë, aty do të gjeni:

Guidë për “Aksionet Marie Curie”: http://cordis.europa.eu/fp7/mariecurieactions/guide_en.html

Lajmërime: http://cordis.europa.eu/fetch?CALLER=FP7_MCA_NEWS_EN

Aktivitete: http://cordis.europa.eu/fetch?CALLER=FP7_MCA_EVENTS_EN

Thirrje për Aplikim: <http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/searchcalls?state=open&theme=people>

Fjalor me terma ndihmës: http://cordis.europa.eu/fp7/mariecurieactions/glossary_en.html


Librari ku do të gjeni legjislacione, programe pune dhe publikime të ndryshme: http://cordis.europa.eu/fp7/mariecurieactions/library_en.html

Një nën-meny me linke ndihmëse të platformave të tjera të kërkimit: http://cordis.europa.eu/fp7/mariecurieactions/links_en.html

Përgjigje për çdo pyetje tuajën: http://cordis.europa.eu/fp7/mariecurieactions/get-support_en.html

Menyja, në të djathtë, “[Highlights](#)” përmban informacione kryesore. Në të do të gjeni publikimet dhe njoftimet me të reja, gjithashtu dhe listën e Aksioneve. Kur klikojmë në një nga “Aksionet Marie Curie” në këtë meny do të gjejmë katër pyetje që i shtjelluam edhe në faqen kryesore të “Aksioneve Marie Curies”, Si të aplikojme, Ku të aplikojmë, Ku ndodhet aplikimi juaj, Si të menaxhojmë një projekt.

Në linkun http://ec.europa.eu/research/fp7/understanding/marie-curieinbrief/overview-funding_en.html do të gjeni një përshkrim më të gjerë të “Aksioneve Marie Curie”.



9

COST - European Cooperation in Science and Technology - Bashkëpunimi European për Shkencën dhe Teknologjinë

COST - Bashkëpunimi European për Shkencë dhe Teknologji - është një nga instrumentet më afatgjatë në mbështetjen e kërkuesve dhe kërkimit shkencor në Europë. Ai është rrjeti i parë ndërqeveritar më i përhapur european, me qëllim koordinimin e aktiviteteve kërkimore, me financim kombëtar. "COST" ofron mbështetje financiare për bashkëpunimin e grupeve specifike në Europë si dhe për koordinimin e aktiviteteve kërkimore. Mbështetja financiare përfshin koston e organizimit të aktiviteteve të rrjetit, takime (koston e udhëtimeve, akomodimin, dietat ditore, etj), organizimin e konferencave, workshop-e, shkëmbime shkencore afatshkurtra, shkolla trajnimi disa ditore, publikime etj. Në këtë program, Shqipëria merr pjesë si një vend me statusin "Vend Jo-COST". "COST" për këto vende financon deri në dy kërkues nga i njëjti vend në një Aksion. Kërkuesit nga vendet "Jo-COST" marrin pjesë në aktivitete e Aksioneve, si takime, misione shkencore afatshkurtër, trajnime, konferenca me shpenzime financiare të mbuluara nga "COST". COST mbështet lëvizshmërinë e kërkuesve në Europë dhe nxit kërkimin shkencorë në nëntë fusha kryesore të treguara me poshtë:

- ◆ [Bio-mjekësi dhe Bio-shkencë Molekulare](#)
- ◆ [Ushqim dhe Agrikulturë](#)
- ◆ [Pyje, Produktet dhe Shërbimet e tyre](#)
- ◆ [Materiale, Fizikë dhe Nanoshkencë](#)
- ◆ [Kimi, Shkencat dhe Teknologjitë Molekulare](#)
- ◆ [Shkenca e Sistemit të Tokës dhe Menaxhimi i Mjedisit](#)
- ◆ [Shkencat e Informacionit dhe Komunikimit](#)
- ◆ [Transport dhe Zhvillimi Urban](#)
- ◆ [Individët, Shoqëritë, Kultura dhe Shëndeti](#)

Faqja zyrtare e [COST](http://www.cost.esf.org/) (<http://www.cost.esf.org/>) është shumë e pasur me informacione mbi këtë program dhe ka strukturën e treguar në Figurën 19. Në këtë faqe do të gjeni menynë kryesore të përbërë nga disa nën-meny, një fushë

ku publikohen historitë kryesore (www.cost.esf.org/about_cost/cost_stories), një fushë ku publikohen njoftimet dhe lajmet (www.cost.esf.org/library/news_releases), një fushë ku publikohen aktivitete dhe eventet (<http://www.cost.esf.org/events>), një pjesë për akses të shpejtë të aksioneve “COST” dhe për thirrjet e hapura të aplikimit. Më poshtë, do të përshkruhen me më shumë detaje menyja kryesore dhe vendet ku mund të gjeni informacionin e nevojshëm për këtë instrument.

The screenshot displays the COST website interface. At the top left is the COST logo with the text 'EUROPEAN COOPERATION IN SCIENCE AND TECHNOLOGY'. To the right are navigation links for 'Home', 'Sitemap', 'FAQ', 'Glossary', 'Links', 'Contact', and 'Jobs'. A search bar is located below these links. The main navigation menu includes 'About COST', 'Domains and Actions', 'Participate', 'Events', 'Library', and 'Members Area'. Below the navigation is a banner for 'Open Call' with a deadline of 30 March 2012. The 'Top Story' section features '40 years of Networks of Science and Technology' with a sub-image of a person holding a molecular model. The 'Latest News' section lists three articles: a tribute to Dr Gerard Butler (19 January 2012), a debate on bacterial adaptation (05 January 2012), and a call for ideas on green engineering (04 January 2012). The 'Events' section lists 'Sustainable Protein Supply' (16 March 2012), 'Planet Under Pressure' (18-19 March 2012), and 'Green Engineering Camp' (02-06 July 2012). A 'Quick Access' sidebar lists various scientific domains like Biomedicine and Molecular Biosciences, Chemistry and Molecular Sciences, Food and Agriculture, Earth System Science, and Forests, their Products and Services. The 'President's Corner' section mentions Dr Angeles Rodriguez-Pelfo. The footer contains logos for the EU RTD Framework Programme, the European Commission, and the Council of the European Union, along with links for 'Legal Notice', 'Accessibility', and 'Sitemap'.

Figura 19: Faqja Web e COST

Çfarë është “COST”?

Informacione rreth programit “COST” mund të gjeni duke klikuar në nën menynë “About COST” të menysë kryesore, ose duke shkuar direkt në linkun http://www.cost.esf.org/about_cost. Aty do të gjeni informacion mbi: [si funksionon “COST”](#), [Misioni dhe Qëllimi i COST](#), [Strukturën e COST](#), [Vendet COST](#), [Committee of Senior Officials](#), [Marrëveshjet e lidhura me vende të ndryshme](#), [Informacion Trajnues mbi pjesëmarrjen në COST](#), [Historitë COST](#) dhe [Informacion mbi Organet Drejtuese dhe Drejtuesit e Programit COST](#).

Fushat e Kërkimit Shkencorë të “COST”

Fushat e Kërkimit Shkencor të “COST” janë nëntë, siç u përmendën me sipër, në nën menynë [Domain and Actions](#) të menysë kryesore, do të gjeni informacione mbi këto fusha (http://www.cost.esf.org/domains_actions). Për çdo fushë, do të gjeni detaje, aksione dhe zonën e rezervuar për pjesëtarët, duke klikuar mbi emrin e secilës prej fushave në menynë, që shfaqet në të majtë të faqes.

Pjesëmarrja në “COST”

Në nën menynë [Participate](#) do të gjeni informacion të dobishëm për ata që duan të punojnë me COST. Në menynë në të majtë të faqes do të gjeni linkun për tu bërë pjesëmarrës në një aksion, [Join an Action](#). Aty do të gjeni informacionin e nevojshëm për tu bërë pjesë e këtij programi.


[Thirrje për aplikim](#) (Open Call) do të gjeni informacion mbi thirrjet për aplikim, duke lexuar informacionin përkatës dhe duke ndjekur hapat do të informoheni me mënyrën e aplikimit.

Në nën menynë [Guidelines](#) do të gjeni rregulla, strategjitë dhe procedurat për implementimin e Aksioneve COST

Libraria, Publikimet, Njoftimet

Në nën-menynë “[Library](#)” të menysë kryesore do e gjeni informacion mbi:

- ◆ [Newsroom](#) - do të gjeni debatet dhe lajmet nga ky program.
- ◆ [Newsletter](#) - broshurat që publikon “COST”.
- ◆ [Publications](#) - do të gjeni të gjithë publikimet që ka bërë “COST” në vite.
- ◆ [Video dhe Audio](#) - do të gjeni informacione në video dhe audio që ka prodhuar “COST” në vite.



Pjesëtarë e platformës Web të “COST”

Duke klikuar në nën-menynë [Member Area](#) do të keni mundësi të aksesoni pjesën e platformës duke u identifikuar me emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin që ju keni. Kjo është një zonë e rezervuar vetëm pjesëtareve të platformës Web.

Kontakto në ”COST”

Ju mund të merrni informacion mbi mënyrën e kontaktimit me pjesëtarët e “COST” duke klikuar në linkun: <http://www.cost.esf.org/service/contact>. Gjithashtu, aty do të njiheni me personat e kontaktit dhe adresën e tyre.

Fjalori i Terminologjive

Në faqen e “COST” me linkun <http://www.cost.esf.org/service/glossary> ju do të gjeni një fjalor të detajuar të shkurtimeve dhe terminologjisë së përdorur në këtë platformë. Ky është një mjet ndihmës për të kuptuar terminologjinë dhe shkurtimet e përdorura në këtë instrument.

Pyetje dhe përgjigje

Në linkun <http://www.cost.esf.org/service/faq> mund t’i jepni përgjigje shumë pyetjeve në lidhje me këtë program, për më tepër vizitoni këtë faqe.

“EUREKA” është një rrjet ndërqeveritar i themeluar në Paris më 17 korrik 1985, nga Konferenca e Ministrave të Jashtëm të 17 vendeve Europiane dhe përfaqësuesve të Komisionit Europian. Me krijimin e programit “EUREKA” fondet publike dhe ato private kanë mbështetur orientimin e tregut drejt kërkimit shkencor, zhvillimit teknologjik dhe zhvillimin e projekteve inovative në fushën e industrisë. Aktualisht, programi “EUREKA” ka 39 anëtarë ku përfshihet edhe Bashkimi Europian, por, ndërkohë, shumë vende të tjera që nuk janë anëtare të saj, marrin pjesë në këtë program, përmes rrjetit të Pikave Kombëtare të Informacionit (NCP). “EUREKA” ka si qëllim të ndihmojë në gjetjen e partnerëve potencialë për projekt-idetë, gjetjen e një tregu për produktin, procesin, apo shërbimin që zhvillohet nga kërkuesi, gjithashtu dhe në marrjen e një emërtimi të njohur ndërkombëtarisht, nga ky program. “EUREKA” përbehet nga këto nën-programe:

1. **CLUSTER** – është një nën-program i rëndësishëm industrial, afatgjatë dhe strategjik. Këto projekte kanë për qëllim të zhvillojnë teknologji të reja me rëndësi kyçe për konkurrencën europiane, kryesisht në TIK, energji dhe, së fundmi, një zhvillim të rëndësishëm ka marrë sektori i Bio-teknologjisë.
2. **UMBRELLA** - janë rrjete tematikë brenda kuadrit të “EUREKA”-s, të cilat përqendrohen në një fushë specifike të teknologjisë, ose të biznesit. Qëllimi kryesor i këtyre rrjeteve është të gjenerojnë dhe të lehtësojnë krijimin e projekteve “EUREKA” në fushat specifike, në të cilat ky program operon.
3. **EUROSTAR** (<http://www.eurostars-eureka.eu/>) - është programi i parë bashkëfinansues, i dedikuar në mënyrë specifike veprimtarisë kërkimore të SME-ve (Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme). Ai është një nën-program europian për kërkim dhe zhvillim në çdo fushë teknologjike, por duke pasur një synim civil dhe si qëllim zhvillimin e një produkti, procesi, apo shërbimi. “Eurostar” stimulon bashkëpunimin ndërkombëtar në projektet e kërkimit dhe novacionit. Në këto projekte përfshihen, së paku, dy pjesëmarrës nga dy vende të ndryshme anëtare të programit “Eurostar”. Pjesëmarrësi kryesor duhet të jetë një SME (Ndërmarrje të Vogla e të Mesme) e regjistruar në një vend anëtar, e cila ka në statusin e saj veprimtari kërkimore.

4. **INDIVIDUAL PROJECTS** - Projektet Individuale - mjeti më i përdorshëm i financimit të EUREKA-s. Ky fond përdoret për projekte të vogla, me një kohëzgjatje të shkurtër, në të cilin duhet të jenë, të paktën, partnerë nga dy vende anëtare në “EUREKA”, rezultati i tyre duhet të jetë një produkt, proces, apo shërbim që sjell zhvillim të rëndësishëm në fushën përkatëse.

Financimi i projekteve “EUREKA” realizohet nga dy burime kryesore: burimet publike që janë Fondet dhe Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Inovacionit dhe burimet nga investimi i pjesëmarrësve. Pjesëmarrësit në këto projekte mund të jenë, kompani të mëdha, ndërmarrje të vogla dhe të mesme, institute kërkimore, universitete dhe institucione të administratës publike.

Linku i faqes zyrtare të këtij programi është: <http://www.eurekanetwork.org>, në këtë faqe do të gjeni informacion të plotë mbi këtë program.



Figura 20: Faqja Web e Projektit Eureka

Në faqen kryesore do të gjeni informacion mbi: [Njoftimet e reja](#), [publikimet](#) e këtij programi dhe [kalendarin e eventeve](#), siç tregohet edhe në Figurën 20. Menyja kryesore do t’ju ndihmojë për të marrë më shumë informacion.

Çfarë është “EUREKA”?

Duke klikuar në tabin “[About Eureka](#)” do të merrni të gjithë informacionin e nevojshëm se çfarë është “EUREKA”. Do të njiheni me historikun dhe strukturën e këtij programi. Duke klikuar në nën-menynë e saj [FAQ](#) do të keni mundësi t’i përgjigjeni pyetjeve që mund t’u lindin mbi këtë projekt.

Lajme, njoftime dhe publikime

Duke klikuar mbi tabin “[News & Media](#)” do të navigoni në njoftimet, eventet, publikimet dhe artikujt që ka kjo platformë. Gjithashtu kjo platformë ka edhe një dhomë shtypi të cilën e gjeni në këtë link <http://www.eurekanetwork.org/press>. Në linkun <http://eureka-innovation.blogactiv.eu/> gjendet blogu i kësaj platforme ku mund të diskutohet mbi çështje të ndryshme.

Aktivitetet e “EUREKA”


Informacion mbi aktivitetet dhe programet e projektit “EUREKA” do t’i gjeni duke klikuar në tabin “[Activities](#)”. Këtu do të gjeni informacion mbi nën-programet e këtij projekti që u përmendën më sipër. Në linkun <http://www.eurekanetwork.org/eureka-innovation-award> do të gjeni informacion mbi “EUREKA Innovation Award 2012”.

Në linkun <http://www.eurekanetwork.org/clean-tech-action> do të gjeni informacion mbi “CleanTech Action” e cila promovon dhe mbështet projektet dhe aktivitetet “EUREKA” në sektorin e teknologjisë së pastër.

Në linkun <http://www.eurekanetwork.org/innovest> do të gjeni “EnnoVest” që është investitori i parë i EUREKA-s i cili gjeneron marrëveshje novative. Në faqen zyrtare të këtij projekti <http://innovest.eurekanetwork.org/> do të gjeni më shumë informacion.

Kërkimi dhe Aplikimi për Projekte

Duke klikuar në tabin “[Project](#)”, ose në linkun <http://www.eurekanetwork.org/projects> do të merrni informacion mbi projektet. Mund të kërkoni projektet nëpërmjet formës së kërkimit në <http://www.eurekanetwork.org/project-search>, të njiheni me mënyrën se si mund të bëheni [pjesëmarrës](#) në këtë program. Në linkun <http://www.eurekanetwork.org/how-to-start-a-project> ndodhet një guidë mbi mënyrën se si duhet të fillojë një projekt. Në linkun <http://www.eurekanetwork.org/propose-a-project-idea> do të gjeni formën e propozimit të një projekt -ideje. Në linkun <http://www.eurekanetwork.org/download-project-application-form> do të shkarkoni formën e aplikimit në projektet “EUREKA”.




Historitë e suksesit në këtë projekt mund t'i gjeni në linkun <http://www.eurekanetwork.org/projects/success-stories>, ku me anën e një forme filtrimi, do ta keni shumë të lehtë të gjeni historitë e suksesit në fushën, shtetin, apo programin tuaj me interes.

Kontaktet dhe Suportet “EUREKA”

Në linkun <http://www.eurekanetwork.org/in-your-country> do të gjeni kontaktet e vendeve anëtare dhe atyre jo anëtare që janë përfaqësues në këtë program. Nëpërmjet një filtri të zgjedhjes së shtetit mund të gjeni kontaktet në vendin tuaj të interesit. Në linkun <http://www.eurekanetwork.org/ese-contacts> do të gjeni kontaktet e departamenteve të programit “EUREKA”. Nëpërmjet formës së komunikimit në linkun <http://www.eurekanetwork.org/feedback> ju mund të çoni një përshtypje drejtuesve të programit “EUREKA”.

Zona e pjesëtarëve të platformës

Nëpërmjet [formës së logimit](#), ju mund të hyni në zonën e rezervuar për pjesëtarët e kësaj platforme.



**AGJENCIA E KËRKIMIT
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT**

Rruga: "Abdi Toptani", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri
E-mail: info@akti.gov.al
www.akti.gov.al